# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5545
E hënë, 6 gusht 2018
çmimi 0.40 €


## Pritje të gjata të mërgimtarëve në pikat kufitare

FAQE 7





Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", ZENUN PAJAZITI FAQE 4-5

# Kërkesa e Luginës për bashkim me Kosovën duhet të merret seriozisht



Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Zenun Pajaziti, ka thënë se ideja e bashkimit të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës me Kosovën nuk është ide e ndonjë partie politike apo lideri në Kosovë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Pajaziti ka thënë se kërkesa e Luginës për bashkim me Kosovën ka qenë ide e shqiptarëve që jetojnë atje madje, sipas tij, ata këtë ide e kanë jetësuar me një referendum më herët. "Pra, buron nga e drejta legjitime e shqiptarëve atje dhe, si e tillë, duhet të merret shumë seriozisht", është shprehur nënkryetari i PDK-së, Zenun Pajaziti. Ai ka siguruar qytetarët e Kosovës se PDK-ja në çdo proces do të jetë kujdestare e ruajtjes së integritetit të vendit dhe të drejtave të shqiptarëve. Pajaziti ka pohuar se shqiptarët që jetojnë në Luginë të Preshevës janë të privuar nga shumë të drejta dhe liri elementare

## AKTUALE

**A DO TA SHESË KOSOVËN HASHIM THAÇI?** F. 11



Bedri ISLAMI

**'PROBLEMI' KOSOVË - SHQIPËRI, I SHPIFUR** F. 11



Shkruan: Jakup KRASNIQI

**BAZA E NATO-S NË KUÇOVË: ÇFARË PËRFITON SHQIPËRIA DHE RAJONI** F. 2

**NJË PJESË E KOMUNËS SË FUSHË-KOSOVËS PA FURNIZIM ME UJË TË PIJES** F. 9

## EKONOMI

**GRURI PO DERGJET NËPËR ARA** F. 8

**RUKIQI: KOSOVËS I DUHEN DEKADA PËR TA ARRITUR STANDARDIN E BE-së** F. 9

## SPORT

**SHTATË SKUADRA TË SUPERLIGËS, NDRYSHIME NË SHTABE TEKNIKE** F. 14

**ROMA INTERESOHET PËR XHAKËN** F. 14

# Qeveria këtë muaj miraton pakon ligjore të reformës shtetërore



Pakoja ligjore e reformës së administratës publike gjatë këtij muaji pritet të miratohet nga Qeveria e Kosovës. Kështu ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" koordinatori për reforma shtetërore, Besnik Tahiri. Ai ka thënë se me miratimin e kësaj pako do të përfitojnë organet vitale të shtetit, do të nivelizohen pagat si dhe do të ketë qartësi në hierarki. Tahiri ka shprehur optimizëm se Kuvendi do t'i japë mbështetje reformës, duke kërkuar nga grupet parlamentare që këtë proces ta shohin si një hap vendimtar drejt forcimit të shtetit FAQE 3

## Aeroplani turk doli nga pista e ANP 'Adem Jashari' për shkak të gabimit të pilotit

FAQE 7





RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Scott: ShBA-ja nuk e ka ndryshuar politikën ndaj Kosovës

BEOGRAD, 5 GUSHT - Spekulimet se administrata e Trumpit ka ndryshuar politikën amerikane ndaj Kosovës po i mohon ambasadori amerikan në Beograd, Kyle Scott. Scott ka mohuar këta zëra, duke theksuar se qëndrimi i Amerikës asnjëherë nuk do të mund të ndryshojë drastikisht. "ShBA-ja beson se pa normalizimin e raporteve dhe marrëveshjen përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk ka stabilitet dhe përparim në Ballkanin Perëndimor", ka thënë Scott.
Në një intervistë për "Radio Beogradin", Scott tha se interesat amerikane nuk varen nga presidenti dhe se qëllimi kryesor mbetet stabiliteti dhe paqja në Ballkan. "Zgjidhja e problemit të Kosovës kërkon udhëheqës të guximshëm dhe gatishmëri për zgjidhje kreative", tha ambasadori amerikan në Beograd.
Ditët e fundit presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka lënë të hapur mundësinë për shkëmbimin e territoreve me Serbinë, të cilën ai po e quan si korrigjim të kufijve. Thaçi po zotohet për bashkimin e Luginës së Preshevës me Kosovën.



# Baza e NATO-s në Kuçovë: Çfarë përfiton Shqipëria dhe rajoni?

**Shndërrimi i bazës ajrore të Kuçovës në bazë ajrore të NATO-s është një mundësi që Shqipëria të ketë një bazë ajrore moderne, pasi kjo bazë do të ketë dy funksione: do të jetë bazë për forcat ajrore të Shqipërisë dhe bazë ajrore për NATO-n**



Tiranë, 5 gusht - Në Shqipëri do të ngrihet baza e parë ajrore e NATO-s në Ballkanin Perëndimor. Vendimi është marrë nga Këshilli i Atlantikut Verior, organi kryesor për vendimmarrjen politike të NATO-s. Fjala është për shndërrimin e bazës ajrore të Kuçovës në bazë ajrore të Aleancës së Atlantikut dhe lajmin e ka bërë me dije vetë kryeministri Edi Rama në një postim në llogarinë e vet në "Facebook".
Ndërkohë, lajmi ka gjetur pasqyrim edhe në mediet ndërkombëtare, nga ato më prestigjiozet e deri tek ato lokale.
Në ShBA, prestigjiozja "Washington Post" shkruan: "Kryeministri Edi Rama njoftoi se 'me fondet e Aleancës së Atlantikut të Veriut dhe në partneritet me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, NATO do të investojë mbi 50 milionë euro për modernizimin e bazës ajrore të Kuçovës".
"Washington Post", duke iu referuar postimit të Ramës, shkruan se ky investim do të shërbejë edhe si bazë kombëtare për forcën ajrore shqiptare dhe do të sjellë një standard të ri për forcat e saj të armatosura.
Mediet ndërkombëtare, përfshirë "Deutsche Welle"-n, sqarojnë se oferta për shndërrimin e bazës së Kuçovës në bazë ajrore të NATO-s u bë 4 muaj më parë nga ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, gjatë një vizite në ShBA. "Dhe ajo u pranua! Shqipëria në territorin e saj ka tri baza ajrore operacionale: Baza Ajrore e Tiranës, ku ndodhet edhe Qendra Kombëtare e Kontrollit dhe Raportimit për NATO-n; Baza Ajrore e Laprakës, në periferi të Tiranës, që përbëhet nga helikopterë që përdoren për transport qeveritar dhe emergjenca; si dhe Baza Ajrore e Kuçovës", shkruan DW.
Avionët luftarakë sovjetikë dhe kinezë që trashëguan baza e Tiranës dhe Kuçovës ishin kaq të vjetër sa vetëm para pak vitesh u bë e mundur të shiten ose për skrap, ose muzeve. "Shndërrimi i bazës ajrore të Kuçovës në bazë ajrore të NATO-s është një mundësi që Shqipëria të ketë një bazë ajrore moderne pasi kjo bazë do të ketë dy funksione: do të jetë bazë për forcat ajrore të Shqipërisë dhe bazë ajrore për NATO-n. Investimi strategjik prej 50 milionë eurosh, vetëm për fazën e parë të projektit, flet se si teknologjinë dhe avionët që do të përdoren. Mjafton vetëm fakti i shndërrimit të saj në një bazë ajrore të NATO-s për të marrë me mend se si do të modernizohen kapacitetet e forcave ajrore vendase", shkruan DW.
Shndërrimi i bazës ajrore të Kuçovës në bazë ajrore të NATO-s është një mundësi që Shqipëria të ketë një bazë ajrore moderne. E mjafton vetëm fakti i shndërrimit të saj në një bazë ajrore të NATO-s, për të imagjinuar se si do të modernizohen kapacitetet e forcave ajrore vendëse.
Përfitime ka edhe rajoni, për të cilin shndërrimi i bazës ajrore të Kuçovës në një bazë të NATO-s tregon vëmendje të shtuar. Përfitime ka BE-ja në synimin e saj për një rajon pranë tij, si Ballkani Perëndimor, që të jetë në siguri, paqe dhe stabilitet.

## Presidenti Ilir Meta në Rugovë

TIRANË, 5 GUSHT - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, vizitoi Rugovën e Pejës, ku u prit nga kryetari i Komunës, Gazmend Muhaxheri, si dhe mori pjesë duke përshëndetur veprimtarinë tradicionale popullore, kulturore e artistike, "Lojërat tradicionale të Rugovës" të mbajtur në fshatin Stankaj, me praninë e mijëra bashkatdhetarëve nga të gjitha trojet shqiptare. Presidenti Meta e nisi ditën në Bjeshkët e Rugovës duke përshkuar me ecje për rreth dy orë së bashku me kampionin e peshëngritjes Erkand Qerimaj, rrugën që lidh Bogën me Shkrelin Me rastin e kësaj vizite, Bashkësia Territoriale Rugovë dhe Këshilli Organizativ "Rugova 2018" i dha presidentit të Republikës me anë të kryetarit të saj, Vesel Nikçi, titullin "Mirënjohje" me motivacionin "Për kujdesin dhe angazhimin e vazhdueshëm për afirmimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të etnorajonit Rugovë". Duke vlerësuar bukuritë e rralla të natyrës shqiptare, Meta vuri në dukje se: "Shpreh kënaqësinë më të madhe që ndodhem sot në mes të këtyre bjeshkëve të mrekullueshme të Rugovës, të cilat janë vërtet mjaft frymëzuese! Janë vërtet mjaft oksigjenuese. Janë vërtet një burim i pashtershëm i atdhedashurisë dhe i sakrificave për kombin e për çështjen kombëtare. Është një kënaqësi e veçantë që jam në Rugovën e Ibrahim Rugovës e të gjithë shqiptarëve! Sikurse ishte kënaqësi të shëtisja sot nga Boga në Shkrelin e Azem Shkrelit e në mjaft vise të tjera, duke shijuar këto bukuri përrallore, që kanë nevojë të vizitohen edhe më shpesh.
I ftoj shqiptarët e Rugovës e Kosovës që në këtë periudhë të vizitojnë Shqipërinë për më shumë det, dhe ne nga Shqipëria, të vijmë këtu në mal, në këto bjeshkë të mrekullueshme. Kështu turizmi do të zhvillohet në mënyrë të pandërprerë, por edhe lidhjet tona do të jenë edhe më të forta", tha presidenti Ilir Meta.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Procesi i reformës së administratës publike është drejt përfundimit

# Qeveria këtë muaj miraton pakon ligjore të reformës shtetërore



**Pakoja ligjore e reformës së administratës publike gjatë këtij muaji pritet të miratohet nga Qeveria e Kosovës. Kështu ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" koordinatori për reforma shtetërore, Besnik Tahiri. Ai ka thënë se me miratimin e kësaj pakoje do të përfitojnë organet vitale të shtetit, do të nivelizohen pagat si dhe do të ketë qartësi në hierarki. Tahiri ka shprehur optimizëm se Kuvendi do t'i japë mbështetje reformës, duke kërkuar nga grupet parlamentare që këtë proces ta shohin si një hap vendimtar drejt forcimit të shtetit**

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 5 GUSHT - Koordinatori për reforma shtetërore, Besnik Tahiri, të dielën ka paralajmëruar se gjatë këtij muaji Qeveria e Kosovës do ta miratojë pakon ligjore të reformës së administratës publike. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se kjo pako ligjore përbën bazën themelore të shtetndërtimit të Kosovës. "Qeveria e Kosovës e ka përfunduar pakon ligjore të reformës së administratës publike, përkatësisht Projektligjin për organizim dhe funksionim të administratës së shtetit, Projektligjin për zyrtarët publikë dhe Projektligjin për pagat. Tani për tani jemi duke e diskutuar me Ministrinë e Financave koston e saktë të kësaj pakoje ligjore në mënyrë që në këtë muaj ta miratojmë në Qeveri, pastaj ta procedojmë në Kuvend për miratim. Kjo pako është reforma më e rëndësishme e administratës së shtetit të cilën tash e dhjetë vjet nuk kemi arritur që ta bëjmë, mirëpo me vullnetin e madh politik dhe me mbështetjen e kryeministrit Haradinaj jemi të bindur se kjo reformë do të kalojë në Kuvend dhe njëherë e përgjithmonë do të ketë qartësi në organizimin e institucioneve të shtetit dhe barazi në paga", ka deklaruar Tahiri.

Ai ka shprehur optimizëm se Kuvendi do t'i japë mbështetje reformës dhe ka kërkuar nga grupet parlamentare që këtë proces ta shohin si një hap vendimtar drejt forcimit të shtetit dhe jo si një agjendë të ngushtë politike. "Kemi bërë konsultim të gjatë me aktorë të ndryshëm, duke filluar me sindikatat, institucionet që i prek kjo reformë, i kemi njoftuar edhe zyrtarët politikë, do të bëjmë në shtator një konsultim më të gjerë edhe me grupet parlamentare në mënyrë që t'i sigurojmë të gjithë se ky është një hap shumë i madh për një shtet dhe një administratë të fortë që synon të integrohet në Bashkimin Evropian. Kërkoj nga të gjitha grupet parlamentare që këtë reformë ta shohin përtej një agjende të ngushtë politike dhe ta shohin si një hap vendimtar drejt forcimit të shtetit të Kosovës. Unë pres që pas një debati këto projektligje do të kalojnë në Kuvend", është shprehur ai.

Tahiri ka theksuar se nga miratimi i pakos ligjore të reformës shtetërore do të përfitojnë organet vitale të shtetit dhe të rendit e të ligjit. "Do të përfitojnë gjyqtarët dhe prokurorët, në veçanti do të përfitojnë mbi tetë mijë policë, pastaj do të përfitojë shëndetësia si dhe të gjithë sektorët e tjerë do të kenë qartësi nga ky proces", ka treguar ai. Tahiri ka bërë me dije se pakoja e reformës shtetërore, në veçanti Projektligji për paga në asnjë situatë nuk rrezikon as stabilitetin fiskal e as parametrat buxhetorë. "E them me përgjegjësi të plotë se Qeveria, në veçanti Ministria e Administratës Publike, e ka analizuar secilin detaj financiar dhe se kostoja e projektligjeve është e kalkuluar sektor për sektor deri në centin e fundit. Prandaj nuk është e vërtetë se kostoja e kësaj pakoje ligjore do të jetë e papërballueshme për buxhetin e Kosovës. Ne e dimë saktë sektor për sektor sa do të kushtojë kjo reformë. Pra, do të ketë një kosto e cila do të menaxhohet me ndihmën e Ministrisë së Financave dhe ministrit Bedri Hamza i cili ka një përvojë të gjatë dhe jam i bindur se kjo kërkesë do të akomodohet", është shprehur ai.

Tahiri ka vlerësuar se përfundimi i reformës së administratës publike do të ndikojë në procesin integrues meqë kjo reformë ka qenë një prej kërkesave kryesore të Bashkimit Evropian. "Ka pasur tentime për këtë reformë edhe nga qeveritë e kaluara të cilat janë munduar ta kalojnë Projektligjin për pagat e kështu me radhë, por një gjë e tillë nuk është realizuar. Realisht BE-ja ka qenë mbështetësja e kësaj reforme, mirëpo këtë reformë ne nuk po e bëjmë as për BE-në e as për ndonjë proces tjetër, mirëpo po e bëjmë për veten tonë, pra për administratën e shtetit tonë, për shërbyesit civilë dhe për krejt qytetarët", ka theksuar Tahiri. Sipas tij, përfitimi kryesor i kësaj reforme në aspektin e rregullimit shtetëror lidhet me saktësinë e funksionimit të të gjitha organizatave buxhetore të shtetit të Kosovës. Me këtë reformë Tahiri ka thënë se do të dihet saktë roli i ministrive, i Qeverisë, i agjencive ekzekutive si dhe do të jenë të përcaktuara saktë përgjegjësitë e zyrtarit publik. "Për herë të parë do të ndërtohet një kontratë e shtetit me të gjitha institucionet publike, do të nivelizohen pagat në mënyrë që të mos ketë katrahurë siç ka qenë përpara si dhe do të ketë një qartësi në hierarki duke u respektuar Kushtetuta e Kosovës", është shprehur Tahiri.

Flet për "Epokën e re", Zenun Pajaziti

# Kërkesa e Luginës për bashkim me

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Zenun Pajaziti, ka thënë se ideja e bashkimit të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës me Kosovën nuk është ide e ndonjë partie politike apo lideri në Kosovë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Pajaziti ka thënë se kërkesa e Luginës për bashkim me Kosovën ka qenë ide e shqiptarëve që jetojnë atje madje, sipas tij, ata këtë ide e kanë jetësuar me një referendum më herët. "Pra, buron nga e drejta legjitime e shqiptarëve atje dhe, si e tillë, duhet të merret shumë seriozisht", është shprehur nënkryetari i PDK-së, Zenun Pajaziti. Ai ka siguruar qytetarët e Kosovës se PDK-ja në çdo proces do të jetë kujdestare e ruajtjes së integritetit të vendit dhe të drejtave të shqiptarëve. Pajaziti ka pohuar se shqiptarët që jetojnë në Luginë të Preshevës janë të privuar nga shumë të drejta dhe liri elementare



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

**Prishtinë, 5 gusht** - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Zenun Pajaziti, ka bërë me dije se partia më e madhe e koalicionit qeverisës do të jetë kujdestare e integritetit të shtetit të Kosovës dhe të drejtave të shqiptarëve. Ai ka deklaruar se kjo parti nuk ka ndonjë qëndrim konkret rreth idesë së presidenti Hashim Thaçi për korrigjimin e kufirit me Serbinë.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Pajaziti ka thënë se PDK-ja mbetet e vendosur për zgjidhjen me dialog të të gjitha çështjeve të mbetura. "Ne nuk është se kemi trajtuar ndonjë propozim a ide konkrete deri më tash, por PDK-ja mbetet si deri më tash, faktori kyç në procese, duke qenë e vendosur për ruajtjen e vlerave të kombit dhe shtetit tonë, pra duke u kujdesur për forcimin e këtyre vlerave të theksuara në Kushtetutën tonë. Ju sigurojmë se do të jemi kujdestarët e ruajtjes së integritetit të vendit tonë dhe të drejtave të shqiptarëve dhe të gjithë qytetarëve pa dallim", ka thënë Pajaziti.

Ai ka treguar se ideja për bashkimin e Luginës së Preshevës me Kosovën është e shqiptarëve të saj dhe jo e ndonjë subjekti apo lideri politik të Kosovës. "Së pari, duhet ta kemi të qartë se ideja e bashkimit të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës me Kosovën nuk është ide e ndonjë partie politike apo lideri në Kosovë. Kërkesa për bashkim me Kosovën ka qenë ide e shqiptarëve që jetojnë atje, madje ata këtë ide e kanë jetësuar me një referendum më herët. Pra, buron nga e drejta legjitime e shqiptarëve atje dhe, si e tillë, duhet të merret shumë seriozisht", është shprehur ai, duke shtuar se vullneti i shqiptarëve të Luginës çdoherë ka ekzistuar për t'iu bashkuar Kosovës. "Se është ky momenti i duhur për të folur për këtë çështje apo jo këtë nuk mund edhe ta parashohim ne me saktësi. Mendoj se në cilido prej momenteve të jetë apo jo si moment i duhur, vullneti i qytetarëve të asaj pjese është për bashkim me Kosovën dhe ai duhet të shfaqet pa ngurrim sepse, siç e dimë, shqiptarët që jetojnë në Luginë të Preshevës janë të privuar nga shumë të drejta dhe liri elementare. Po ashtu, në periudhat e rënda të historisë sonë kanë ndodhur ndryshime kufijsh në dëm të shqiptarëve. Pra, njerëzit andej e kanë një kujtesë kombëtare historike që i shtyn t'i kërkojnë të drejtat e tyre. Prandaj edhe si rezultat i kësaj rrjedhe historike edhe të një shtypje të vazhdueshme, atje kemi braktisje të trojeve nga gjeneratat e reja", ka thënë Pajaziti.

**"Epoka e re":** *Z. Pajaziti, së fundi tërë skena politike është përfshirë në debatin rreth propozimit të presidentit Hashim Thaçi që në dialog me Serbinë do ta paraqesë kërkesën e shqiptarëve të Luginës së Preshevës për bashkim me Kosovën. Cili është qëndrimi i PDK-së rreth kësaj çështje?*

**Pajaziti:** Ne nuk është se kemi pasur ndonjë kërkesë eksplicite apo diçka konkrete që të marrim ndonjë qëndrim si parti. PDK-ja ka qenë dhe mbetet e vendosur që duhet të vazhdohet dialogu me Serbinë për normalizimin e marrëdhënieve dhe gjetjen e një zgjidhje më afatgjatë. Si parti, jo vetëm se kemi qenë këmbëngulës që ky proces të ecë përpara, por edhe jemi përfshirë në të gjitha etapat e këtij procesi, duke qenë pjesë e rëndësishme e dialogut. Pra, kemi qenë dhe jemi të përcaktuar që me dialog të zgjidhen të gjitha kontestet që kemi me fqinjët.

**"Epoka e re":** *Por rreth idesë konkrete të presidentit Thaçi, cili është vlerësimi juaj?*

**Pajaziti:** Së pari, duhet ta kemi të qartë se ideja e bashkimit të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës me Kosovën nuk është ide e ndonjë partie politike apo lideri në Kosovë. Kërkesa për bashkim me Kosovën ka qenë ide e shqiptarëve që jetojnë atje, madje ata këtë ide e kanë jetësuar me një referendum më herët. Pra, buron nga e drejta legjitime e shqiptarëve atje dhe, si e tillë, duhet të merret shumë seriozisht.

**"Epoka e re":** *Meqenëse Kosova dhe Serbia po hyjnë në fazën finale të dialogut, a është ky momenti i duhur për ta hapur këtë çështje?*

**Pajaziti:** Se është ky momenti i duhur për të folur për këtë çështje apo jo këtë nuk mund edhe ta parashohim me saktësi. Mendoj se në cilido prej momenteve të jetë apo jo si moment i duhur, vullneti i qytetarëve të asaj pjese është për bashkim me Kosovën duhet të shfaqet pa ngurrim sepse, siç e dimë, shqiptarët që jetojnë në Luginë të Preshevës janë të privuar nga shumë të drejta dhe liri elementare. Po ashtu, në periudhat e rënda të historisë sonë kanë ndodhur ndryshime kufijsh në dëm të shqiptarëve. Pra njerëzit andej e kanë një kujtesë kombëtare historike që i shtyn t'i kërkojnë të drejtat e tyre. Prandaj edhe si rezultat i kësaj rrjedhe historike edhe të një shtypje të vazhdueshme, atje kemi braktisje të trojeve nga gjeneratat e reja.

**"Epoka e re":** *Mendoni se institucionet e Kosovës e kanë për obligim të merren me kërkesën e shqiptarëve të Luginës?*

Pajaziti: Procesi i dialogut mes Kosovës dhe Serbisë është një proces i gjatë, i cili ka filluar mbi bazën e një pajtimi me partnerët tanë ndërkombëtarë pas luftës dhe natyrisht se ky proces duhet të vazhdojë me këtë partneritet duke i marrë parasysh gjithmonë kërkesat legjitime të shqiptarëve. Në rastin tonë nëse po flitet për një zgjidhje afatgjatë dhe nëse ka një vullnet të dyanshëm do të ishte mirë të gjendet një zgjidhjeje në tavolinën e dialogut. Kjo do të sillte një paqe afatgjatë për Ballkanin dhe do të krijohej me të vërtetë një ambient i sigurt për gjeneratat që vijnë. E kaluara e Ballkanit nuk është edhe aq shumë shpresëdhënëse që çështjet e kufijve të zgjidhen në kohë paqeje apo me marrëveshje. Mirëpo ne nuk bënë t'i humbim shpresat. Po e përsëris se është e rëndësishme që i gjithë ky proces duhet të përcillet me partneritet të ngushtë me mekanizmat që po e mbështesin dhe po e ndërmjetësojnë këtë proces. Gjithashtu, do të duhej që këto tema të mos përdoreshin për kalkulime politike elektorale qysh po ndodh ditët e fundit.

**"Epoka e re":** *Pra ende nuk mund të themi nëse PDK-ja e përkrah apo jo idenë e presidentit për korrigjim të kufirit me Serbinë?*

**Pajaziti:** E thashë edhe më herët se PDK-ja mbetet e vendosur për zgjidhjen me dialog të të gjitha çështjeve të mbetura edhe si kushte për t'u avancuar në procesin e integrimit në BE. Ne nuk është se kemi trajtuar ndonjë propozim a ide konkrete deri më tash, por PDK-ja mbetet si edhe deri më tash, faktori kyç në procese, duke qenë e vendosur në ruajtjen e vlerave të kombit

# Kosovën duhet të merret seriozisht



dhe shtetit tonë, pra duke u kujdesur për forcimin e këtyre vlerave të theksuara në Kushtetutën tonë. Ju sigurojmë se do të jemi kujdestarët e ruajtjes së integritetit të vendit tonë dhe të drejtave të shqiptarëve dhe të gjithë qytetarëve pa dallim.

**"Epoka e re":** *Idenë e korrigjimit të kufirit me Serbinë e kanë kundërshtuar partnerët e koalicionit qeverisës derisa opozita ka shprehur mendime të ndryshme. Mendoni se do të duhej të gjendet një konsensus mes subjekteve politike për këtë çështje?*

Pajaziti: Personalisht mendoj se ka një lojë fjalësh me termat që po përdoren. Edhe për demarkacionin me Malin e Zi në fund patën një farë pajtimi me një pjesë të atyre që e kishin kundërshtuar këtë proces të cilët thanë se pajtohemi, por do ta bëjmë një farë korrigjimi të kufirit. Pra, kjo puna e korrigjimit të kufirit më shumë ka të bëjë me justifikimin e veprimeve politike sesa me diçka që në praktikë mund të ndodhë. Të njëjtit tash janë kundër korrigjimit të kufirit me Serbinë. Mendoj se qëndrimet politike duhet të mos jenë të ngutshme. I takon koalicionit qeverisës që të ketë një koordinim të plotë në mes të gjitha partive politike të koalicionit, por edhe të opozitës. Pra, duhet të kemi një konsensus sepse kjo është çështja më serioze me të cilën po përballemi prej shpalljes së pavarësisë. Duhet të jemi të kujdesshëm në këtë drejtim dhe nuk duhet askush të kalkulojë politikisht ngushtë me temat e tilla.

**"Epoka e re":** *Në opinion ekziston droja se pas këtyre ideve mund të fshihet ndarja e Kosovës apo ndonjë status special për veriun e vendit. I shihni të mundshme këto opsione?*

**Pajaziti:** Nuk jam i prirë t'u besoj këtyre teorive konspirative. Frika e tillë vjen natyrshëm nëse e kujtojmë të kaluarën tonë me Serbinë. Pikërisht kjo frikë duhet të na mbajë neve të bashkuar në kuptimin e koordinimit politik. Në rastin tonë, Serbia është e interesuar të nxjerrë sa më shumë të drejta për serbët që jetojnë në Kosovë, ndërsa ne duhet të synojmë t'i trajtojmë të drejtat e gjithë qytetarëve në Kosovë, po ashtu edhe të drejtat e gjithë shqiptarëve që jetojnë edhe andej kufirit. Kjo është diçka e logjikshme që ne duhet të kujdesemi. Pra, ky është një rast i mirë që përmes dialogut të shikojmë t'i zgjidhim të gjitha problemet që ne i kemi. Besoj se i kemi marrë mësimet e nevojshme nga krejt çfarë kemi kaluar dhe t'i bëjmë veprimet e duhura për vendin tonë.

# ‘PROBLEMI’ KOSOVË - SHQIPËRI, I SHPIFUR



Shkruan: Jakup KRASNIQI

Për njerëzit me njohuri mesatare e, mbase, edhe me përgjegjësi mesatare, Shqipëria dhe Kosova problemin shekullor e kryesor e kanë me Serbinë e jo njëra me tjetrën. "Problemi" i shfaqur në medie mes Thaçit e Berishës, mes dy "miqve" të vjetër, është si lufta e Bali Katravellës me mullit e erës?!

Deklarata e Sali Berishës për deklaratën e papërgjegjshme të Thaçit për Preshevën ishte një goditje e saktë, ndonëse nuk jam prej atyre që e vlerësoj Berishën për goditje të sakta. Por, edhe në këtë rast u vërtetua ajo thënia e njohur e popullit: "S'ke nevojë që të kesh armiq, mjafton ta thuash të vërtetën që t'i krijosh ata"!

Përgjigjja që Thaçi i dha Sali Berishës është përgjigje më shumë se idhnake. Madje, edhe po të ishte e vërtetë ajo që Thaçi e tha për të, pse duhej të thuhej më kaq shumë vonesë?! Kur dihet se Milloseviqi, Bin Ladeni dhe Arkani më nuk janë në jetë? A mos po del në këtë rast sedra e Thaçit mbi interesin e kombit? A kështu na qenka udhëheqësi i pagabueshëm e "ylli i shekullit"? Si po shkruajnë autorët e huaj e të blerë nga Thaçi?

Ky Thaçi po del që të jetë me sedër të madhe, me inat të papërmbajtshëm ndaj një mendimi të kundërt të një miku të tij, siç ka deklaruar vetë shumë herë, pse në rastin e Kosovës mos ta vinte edhe interesin e tij mbi interesin e Kosovës e Preshevës marrë së bashku? Mbase, sjellja e tij me miqtë në këtë mënyrë sikur i është bërë traditë.

Pozicioni personal i Thaçit është pozicion për ruajtjen e miqve të vjetër dhe krijimin e të rinjve dhe jo vetëm brenda kombit. Ai gjatë këtyre viteve ka krijuar shumë armiq në Kosovë sa ka mbetur i rrethuar vetëm me armiqtë e tij të djeshëm të cilëve po u shpërndanë pozita shtetërore si të ishin ato karamele se për dekorime e medalje mos të flasim?!

Kjo gjuhë e vendosur në komunikimet e politikës shqiptare nuk nderon njeri e më së paku njerëzit me përgjegjësi shtetërore. Edhe gjuha që u përdor nga një medie shqiptare e Shqipërisë për Thaçin ishte e të njëjtit nivel. Mbase këto medie partizane, të cilat janë me bollëk, janë krijuar nga "udhëheqësit" e këtij niveli?!

Si është politika tek ne, janë edhe mediet si krijesa të këtij niveli, as profesionale as intelektuale e njerëzore!

Koha është duke kërkuar që më shumë se kurrë, si nga politika ashtu edhe mediet që me gjithë kapacitetet e tyre profesionale e kombëtare të vihen në shërbim të kombit dhe atdheut. Koha e kërkon bashkimin e territorit e jo shkëmbimin e një hapësire shqiptare me një tjetër! Së pari duhet garantuar mirë atë që e ke, pastaj syno edhe të pamundshmen për ta arritur të mundshmen! Kjo gjuhë komunikimi që kanë instaluar disa politikanë shqiptarë nuk prodhon suksesin. Ndryshimi është bërë domosdoshmëri.

# Rezoluta e ‘pashpresë’ e opozitës për dialogun



**Prishtinë, 5 gusht** - Rezoluta për dialogun me Serbinë, e propozuar nga Partia Socialdemokrate, nuk kishte marrë një epilog në Kuvend për shkak të mungesës së kuorumit. Opozita nuk ishte dhe vazhdon të mos jetë unike në qëndrimet e veta në lidhje me këtë rezolutë, por emëruesi i përbashkët ishte kërkesa që Kuvendi ta mandatojë një ekip përfaqësues në bisedimet me Serbinë, duke ia mohuar rolin prijës në këtë proces presidentit Hashim Thaçi. Sidoqoftë, ky vullnet politik që shprehej përmes këssaj rezolute nuk është finalizuar me votim. Propozuesit e kësaj rezolute thonë se ajo është në Kuvend dhe duhet të procedohet për harmonizim dhe votim.

Shefi i Grupit Parlamentar i Partisë Socialdemokrate, Dardan Sejdiu, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se rezoluta është e vetmja rrugë përpara në mënyrë që i gjithë procesi i dialogut të jetë në 'binarët' e legjitimitetit politik. "Besoj se në mbledhjen e parë të Kuvendit, e që besoj se do të duhej të ishte e shpejtë të votohet kjo rezolutë dhe kështu të vendosim dialogun në binar. Besoj se çdo politikan dhe parti politike racionale e ka të qartë që me një opozitë e cila i ka 58 vota mund të vendoset gjithë dialogu në binarë të kontrollit të Kuvendit. Çdo ikje nga vendosja e dialogut nën kontroll të Kuvendit është veç, si të themi, alibi për ta mirëmbajtur këtë lloj dialogu. Pra, edhe partitë në pushtet edhe partitë opozitare të cilat nuk votojnë këtë rezolutë duan që të mirëmbajnë këtë lloj dialogu. Asgjë më shumë. E ky dialog nuk ka as legjitimitet, por edhe ka nxjerrë jashtëzakonisht rezultate të dëmshme për vendin", ka thënë Sejdiu.

Ai ka thënë se Partia Socialdemokrate ka ftuar të gjithë deputetët e partive politike që të takohen dhe të ulen në një tryezë për harmonizimin e rezolutës dhe, siç thotë ai, të arrihet një konsensus që dialogu të kthehet në Kuvend. Kurse deputeti Xhelal Sfeçla nga Lëvizja Vetëvendosje ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se proceset e dëmshme të cilat po i bëhen Kosovës nuk mund të ndalen me rezoluta. Siç thotë Sfeçla, të gjithë e njohin Hashim Thaçin e, sipas tij, ai me rezoluta nuk mund të ndalet. "Ne e dimë se Kuvendi i Kosovës ka një praktikë të nxjerrjes së rezolutave. Ekzekutivi ka një praktikë të shkeljes së atyre rezolutave, kështu që nuk e di se sa këto procese të dëmshme mund të ndalen me rezoluta. Kuvend nuk ka më deri më 15 shtator. Ne mund të bëjmë lojë fjalësh sa të doni. Derisa ishte Kuvendi ata [PSD] koketonin me Kadri Veselin e Ramush Haradinajn, duke kaluar ligje e duke thyer bllokadën e dy subjekteve opozitare. Tash Thaçi, Veseli e Haradinaj nuk kanë nevojë më për Kuvend dhe nuk e mbledhin Kuvendin. Tash kanë mbetur të gjitha mënyrat demokratike për ta ndalur Hashimin. Nuk ka mbetur rrugë tjetër ose ta presim 15 shtatorin kur fillon punën Kuvendi", ka thënë Sfeçla.

Edhe në Lidhjen Demokratike të Kosovës deputetët thonë se nuk do ta përkrahin rezolutën e Partisë Socialdemokrate. Naser Rugova, deputet i LDK-së, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" një rezolutë si ajo e PSD-së do të duhej të vinte nga institucionet kompetente, konkretisht Qeveria e Kosovës. "Ideja e PSD-së është e vonuar dhe nuk do të sjellë zgjidhje konkrete pragmatike dhe frymë konsensuale që të ecim tutje. Prandaj ne vlerësojmë se [duhet të këtë] zgjedhje, legjitimitet politik nga qytetarët, pastaj hapa të tjerë në ndërtimin e konsensusit dhe siç është në fuqi rezoluta e gushtit 2012 që me procesin e dialogut duhet të udhëheqë kryeministri i ri i vendit", ka thënë Rugova.

Me versionet e rezolutave të paraqitura nga opozita në lidhje me dialogun me Serbinë nuk pajtohen partitë në pushtet, sidomos Partia Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Ato i kanë dhënë mbështetje presidentit Thaçi në rolin prijës në dialog dhe kanë ftuar opozitën të bashkohet në procesin final të bisedimeve me Serbinë, përmes krijimit të një ekipi gjithëpërfshirës dhe hartimit të një platforme të përbashkët, si qëndrim zyrtar i Kosovës karshi bisedimeve me Serbinë.

Propozimet e opozitës për dialogun kanë dallime, por e përbashkëta e tyre është që dialogun nuk mund ta udhëheqë presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi.

Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike ka dalë me raport final rreth incidentit të aeroplanit turk të kompanisë "Turkish Airlines" dy vjet më parë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari"

# Aeroplani turk doli nga pista e ANP 'Adem Jashari' si shkak i gabimit të pilotit

Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike ka përfunduar hetimet rreth incidentit të aeroplanit turk të kompanisë "Turkish Airlines" i cili më 2 maj të vitit 2016 doli nga pista pas aterrimit në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari". "Epoka e re" ka arritur ta sigurojë raportin final profesional të këtij komisioni ku thuhet se aeroplani e kaloi pragun e pistës 35 rreth 80 ft, që i bie rreth 30 ft më lart se lartësia normale e kalimit të pragut. "Kjo çoi në një aterrim të gjatë, rreth 100 metra përtej zonës së prekjes në tokë, që i bie rreth 1 030 metra përtej pragut të pistës", thuhet në raport



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 GUSHT - Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike ka përfunduar hetimet rreth incidentit të aeroplanit turk të kompanisë "Turkish Airlines" i cili më 2 maj të vitit 2016 doli nga pista pas aterrimit në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari".

Gazeta "Epoka e re" ka arritur ta sigurojë raportin final profesional të Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike mbi incidentin e aeroplanit Boeing B737-800, TC-JFY në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", më 2 maj 2016. Në raport thuhet se faktorët shkaktarë të këtij incidenti ishte lartësia shumë e madhe e kalimit të pragut të pistës nga piloti, kombinuar me pozicionimin e gjatë të aterrimit dhe prekjen e vonuar në tokë përtej zonës së prekjes në tokë. "Më 2 maj 2016 në orën 19:31 aeroplani doli nga hapësira operative pas aterrimit në pistën 35 në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës 'Adem Jashari'. Aeroplani u ndal në bari afër pistës. Të gjithë pjesëtarët e ekuipazhit dhe pasagjerët në bord shpëtuan pa lëndime, përveç gjashtë pasagjerëve që kërkuan ndihmë mjekësore për shkak të shqetësimit dhe frikës", thuhet në raportin e Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike.




Ky raport është miratuar nga Bordi i KHAIA-s dhe tashmë i është dorëzuar Qeverisë së Kosovës dhe Kuvendit. Në këtë raport më tej bëhet me dije se sipas informacioneve më të fundit për erën nga kontrollori i kullës dhe 'Metar' aktual, ekuipazhi i fluturimit ishte i vetëdijshëm për gjendjen e motit në aeroport.

Të gjeturat e Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike janë këto: Gjatë afrimit të dy anëtarët e ekuipazhit të kabinës e kishin vërejtur që po shkonin shumë lart mbi shtegun e afrimit; Aeroplani e kaloi pragun e pistës 35 rreth 80 ft, që i bie rreth 30 ft më lart se lartësia normale e kalimit të pragut. Kjo çoi në një aterrim të gjatë, rreth 100 m përtej zonës së prekjes në tokë, që i bie rreth 1030 m përtej pragut të pistës; CRM-ja gjatë fluturimit nuk ishte në përputhje me procedurat standarde të operimit të operatorit; Shpejtësia ajrore me rastin e prekjes në tokë ishte rreth 5 nyje më lart se VREF dhe shpejtësia tokësore në atë kohë ishte 162 nyje; Sipas analizave të erës nga operatori i linjës ajrore, komponenti i erës në drejtim të njëjtë me fluturimin ishte rreth 13 nyje, por brenda vlerës maksimale të lejuar të erës në drejtim të njëjtë me fluturimin; Ekuipazhi i fluturimit u mundua të kalonte nga pista në pistën taksi me shpejtësi mbi shpejtësinë normale taksi. "Faktorët shkaktarë shkaku i këtij incidenti serioz ishte lartësia shumë e madhe e kalimit të pragut të pistës, kombinuar me pozicionimin e gjatë të aterrimit dhe prekjen e vonuar në tokë përtej zonës së prekjes në tokë. Rezultati ishte prekja në tokë rreth 1030 m përtej pragut të pistës 35. Menaxhimi i burimeve të ekuipazhit nuk ishte në përputhje me PSO-në e operatorit. Ekuipazhi i fluturimit nuk ndërmori me kohë procedurën e kthimit. Kjo do të kishte parandaluar daljen nga pista", thuhet në të gjeturat e raportit të Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike.

Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA) është themeluar në bazë të Ligjit nr. 03/L- 051 për Aviacionin Civil. KHAIA është përgjegjëse për hetimin e aksidenteve dhe incidenteve në aviacion brenda Kosovës ose ku përfshihen avionët e regjistruar në Kosovë, kudo qofshin ata.

KHAIA bënë hetim në mënyrë të pavarur dhe në koordinim të plotë ndërmjet palëve të përfshira. KHAIA është e autorizuar të kërkojë nga cilido autoritet publik i Kosovës dhe/ose person privat ose organizatë në Kosovë që t'i japë asaj përkrahjen e nevojshme për kryerjen e një hetimi të përcaktuar me ligjin për aviacionin civil ose një hetimi i cili kërkohet sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare ose organizate ndërkombëtare të aviacionit.

# Pritje të gjata të mërgimtarëve në pikat kufitare

PRISHTINË, 5 GUSHT (ER) - Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar ka përditësuar të dielën të dhënat lidhur me pritjet e qytetarëve në pikat kufitare të Kosovës. Sipas Qendrës, për të hyrë në Kosovë qytetarët më së shumti presin në pikën kufitare në Merdarë. Për të hyrë në Kosovë, qytetarët presin deri në dy orë e gjysmë, e për të dalë nga Kosova përmes pikës në Merdarë pritjet janë 70 minuta. Pastaj, pritjet më të gjata për të dalë nga Kosova janë në pikën te Dheu i Bardhë. Pritjet për të hyrë në Kosovë përmes kësaj pike janë 60 minuta, e për të dalë përmes kësaj pike kufitare janë 90 minuta. Ndërsa pritjet më të gjata për të dalë nga Kosova janë në pikën kufitare në Mutivodë, prej 90 deri 150 minuta.



# Rukiqi: Kosovës i duhen dekada për ta arritur standardin e BE-së

PRISHTINË, 5 GUSHT - Për ta arritur standardin jetësor të Bashkimit Evropian (BE), Kosovës do t'i duhen dekada. Kështu ka thënë në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", Berat Rukiqi, kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës. Në këtë intervistë Rukiqi ka folur edhe për shkallën e lartë të informalitetit, veçmas në veri të vendit, si dhe për vendimin e Qeverisë për vendosjen dhe më pas heqjen e masës mbrojtëse për importet e produkteve bujqësore.
"Kosova ka nivelin më të ulët të investimeve të huaja direkte dhe ka mungesë të kapitalit të freskët. Në të njëjtën kohë, shumë sfida të pasluftës e kanë orientuar fokusin e politikave në diçka që ka qenë më prioritare për një kohë, sidomos investimet në infrastrukturë. Pastaj është krijuar një kategori e madhe e personave që përfitojnë nga skemat sociale dhe realisht instrumenti kryesor i atyre që udhëheqin me politikat, buxheti i ka pasur kufizimet për të përkrahur më hovshëm zhvillimin ekonomik", ka thënë Rukiqi.
Ai ka shtuar se jostabiliteti që ka ardhur si pasojë e sfidave të shtetndërtimit e ka kufizuar një rritje më të shpejtë të zhvillimit ekonomik. "Kjo rritje ekonomike nuk po garanton. Para së gjithash, rritja ekonomike vjen prej burimeve të paqëndrueshme, ka një varësi të madhe nga konsumi dhe në këtë aspekt është problematike që ne ta kemi shkallën e zhvillimit atë që po pretendojmë, e cila mund të reflektohet në uljen e papunësisë dhe rritjen e mirëqenies sociale dhe rritjen e standardit të jetesës në përgjithësi", ka deklaruar Rukiqi.
Në pyetjen se cilat janë ato lehtësira që Qeveria e Kosovës do të duhej të bënte për industrinë prodhuese, Rukiqi është përgjigjur: "Nëse e shohim cilat janë problemet që i kemi, ato janë energjia elektrike, pastaj aftësimi i fuqisë punëtore si dhe kemi konkurrencën e padrejtë. Fokusi i Qeverisë duhet të jetë në këto tri pika".





# Vjedhje në filialin e një banke në Fushë-Kosovë

FUSHË-KOSOVË, 5 GUSHT - Një rast i vjedhjes së rëndë ka ndodhur në fundjavë në Fushë-Kosovë. Sipas njoftimit të Policisë së Kosovës, rasti është raportuar të shtunën në orën 02:49. Është raportuar se persona të panjohur e të dyshuar kanë depërtuar brenda objektit të një filiali bankar dhe me forcë kanë hapur kasafortën.
Sipas policisë, të njëjtit janë larguar në drejtim të panjohur. Rasti është duke u hetuar.

# Paga mesatare në Zagreb afër një mijë euro



ZAGREB, 5 GUSHT - Paga mesatare në Zagreb për muajin prill ishte 7 235 kuna (afër një mijë euro) dhe ishte 5.1 për qind më shumë se në të njëjtin muaj të vitit të kaluar. Paga mesatare më të larta në atë muaj kanë marrë të punësuarit në shërbime financiare, përveç sigurimeve dhe fondeve të pensioneve, 11 966 kuna, ndërsa në nxjerrjen e naftës së papërpunuar dhe gazit natyror arriti në 11 259 kuna. Pagën mesatare më të madhe se dhjetë mijë kuna e kanë pasur të punësuarit në industrinë farmaceutike, 10 772 kuna.

# Gruri po dergjet nëpër ara



## Fushata e korrje-shirjes së grurit ende nuk ka përfunduar si pasojë e reshjeve të vazhdueshme të shiut

EPOKA E RE Ismail REXHEPI

FERIZAJ, PRISHTINË, LIPJAN, 5 GUSHT - Fushata e korrje-shirjeve të grurit, edhe pse thuhej se para 20 ditësh kishte hyrë në fazën përfundimtare, nuk doli ashtu. Ende nuk janë kryer më shumë se 60 për qind të sipërfaqeve që ishin me grurë. Deri te kjo erdhi si pasojë e reshjeve të përditshme të shiut, sidomos në kohën e korrjes së grurit. Të shumta janë grunajat që po dergjen nëpër ara. Të pakta janë ato grunaja që arritën të korren sivjet për shkak të lagështisë së madhe ku kombajna nuk ka mundur të hyjë. "Edhe sot disa hektarë grurë janë të nxira që kanë mbetur pa u korrur te i vendi i quajtur 'Buqalla' afër hekurudhës dhe fshatrave Rubovc e Kojskë", ka bërë me dije bujku nga fshati Gumnasellë i Komunës së Lipjanit, Adnan Sadiku.

Korrje-shirjet i ka penguar lagështia si pasojë e reshjeve të përditshme të shiut. Gruri ende gjendet i pakorrur dhe i tëri në ujë. Këto grunaja të pakorrura janë të bujqve të fshatit Llugaxhi të Komunës së Lipjanit, afër magjistrales Prishtinë -Shkup dhe fshatit Babush të Muhaxherëve. Jo larg këtyre grunajave është edhe fabrika e miellit, ku nga biseda me pronarin mësojmë se sivjet kanë arritur të grumbullojnë pak grurë si pasojë që shumica e grurit edhe është nëpër ara.

Edhe pronarët e mullinjve si "Qali" dhe ai në fshatin Smallushë i kanë pohuar gazetës të dielën se sivjet ka shumë pak grurë që sjellin bujqit, sepse shumica e sipërfaqeve nuk janë korrur, si dhe ato të cilat ishin fshirë kanë pasur rendimente shumë të ulëta. Madje një bujk nga 70 ari me grurë kishte marrë vetëm gjashtë thasë.

Sivjet nuk kishte bereqet. Të rralla janë ato grunaja që për një hektar janë marrë 2 mijë kilogramë grurë. "Shkaktarë kanë qenë shirat e shpeshta, dëmtimet nga breshëri si dhe në periudhë të gjatë koha e vranët. Madje, sipas tyre, çka është edhe më e keqja, edhe ai grurë që merret është i cilësisë shumë të dobët", kanë pohuar pronarët e mullinjve që gjenden në Komunën e Lipjanit.

Sipërfaqe të shumta të grurit të pakorrur që ende dergjeshin hasëm edhe në fshatin Cërnillë të Komunës së Ferizajt, në të majtë të rrugës në drejtim të hyrjes në këtë fshat. Edhe këtu na thanë se si pasojë e lagështisë së madhe nuk ka mundur të hyjë kombajna. "Pavarësisht prej kohës, më nuk ia vlen të korret gruri, sepse ai nuk jep asnjë rendiment. Me një fjalë, duhet paguar për korrje së koti", kanë pohuar bujqit në këtë fshatë. Nga terreni mësojmë se gjendje e ngjashme mbretëron edhe në fshatin Sazli të kësaj komune.

Rrugëtimi ynë pas këtyre dy komunave ka vazhduar edhe në fshatrat e Gollakut të Komunës së Prishtinës, në Makovc, Grashticë, Koliq Keqekollë e Prapashticë. Edhe në këto fshatra malore gjendja pothuajse ishte e njëjtë me fshatrat e rrafshit. "Edhe kur vera merrte e mirë, pra pa të reshura të shiut në afatin optimal të korrjeshirjeve në fshatin Keqekollë gruri korrej për shkak të kushteve atmosferike më se voni. Po ashtu, edhe rendimente të hairit kurrë nuk ka pasur. Mirëpo sivjet është shumë më keq, jo që nuk janë korrur grunajat, por ato s'kanë kokërr të bereqetit", ka thënë bujku nga fshati Keqekollë, Faik Ramadani.

Edhe në disa fshatra të Komunës së Shtimes kishte sipërfaqe të grurit të pakorrur. Gruri në sipërfaqe të mëdha po dergjej nëpër ara që ka mbetur pa u korrur.

Qytetarët e shumtë janë shprehur se kjo gjendje do të ndikojë edhe në rritjen e çmimit të miellit e të bukës, sepse shumë pak grurë është marrë sivjet nga arat e Kosovës.



## Një pjesë e Komunës së Fushë-Kosovës pa furnizim me ujë të pijes



FUSHË KOSOVË, 5 GUSHT - Rreth 60 mijë banorë të Komunës së Fushë-Kosovës nuk kanë qasje në ujë të pijes nga ujësjellësi rajonal "Prishtina". Një gjë të tillë e ka konfirmuar edhe drejtori i kësaj kompanie publike, Ilir Abdullahu, i cili ka premtuar se problemi do të zgjidhet brenda këtij viti. "Kostoja e këtij investimi arrin rreth 450 mijë euro, një investim i cili ia vlen për 60 mijë konsumatorë të cilët kanë nevojë të kenë ujë të pijes. Projekti është përfunduar. Ne si kompani kemi përfunduar 2.2 kilometra një tubacion i cili do ta zgjidhte problemin e Fushë-Kosovës edhe për vitet e ardhshme. Unë jam optimist se kjo punë do të kryhet gjatë këtij viti dhe konsumatori i Fushë-Kosovës do të ketë furnizim", ka thënë Abdullahu.

# Gjilani merr 800 mijë euro nga Qeveria për përfundimin e lumit 'Mirusha'

GJILAN, 5 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur gjatë fundjavës në takim pune zëvendëskryeministrin e parë të Kosovës, Behgjet Pacollin, i cili ka qenë i shoqëruar nga ministri në detyrë i Mjedisit, Fatmir Matoshi, me të cilin kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për investimin në lumin "Mirusha". "Kishim në një vizitë pune zëvendëskryeministrin Pacolli dhe ministrin në detyrë, Matoshi, me të cilin kemi nënshkruar memorandum bashkëpunimi për përfundimin e projektit të lumit 'Mirusha' dhe trajtimin e ujërave të zeza në zonën urbane. Me mjetet prej 800 mijë eurosh që po destinohen nga Qeveria e Kosovës për projektin më kapital, sot po dëshmohet edhe për qytetarët se është fjala për përfundimin e projektit", ka thënë Haziri.

Kurse zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli ka bërë me dije se kjo vizitë ka të bëjë me konfirmimin e Ministrisë së Mjedisit se nga java e ardhshme Gjilanit do t'i jepen 400 mijë euro dhe në fillim të vitit 2019 edhe 400 mijë euro të tjera. Ndërsa Fatmir Matoshi, ushtrues detyre i ministrit të Mjedisit, ka thënë se këto mjete buxhetore dedikohen për ambient dhe kryesisht për investime në fushën e mjedisit.





## Ahmeti kërkon ndihmën e qytetarëve për ruajtjen e ambientit

PRISHTINË, 5 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka reaguar ndaj prerjes së dhjetëra drunjve në lagjen "Bregu i Diellit". Ai ka thënë se është marre kryerja e këtij veprimi dhe, sipas tij, është e pakuptueshme një ngjarje e tillë. Ahmeti ka kërkuar nga qytetarët që kur të shohin veprime të tilla menjëherë të lajmërojnë policinë ose komunën. "Dikush i ka pre mbrëmë mbi 10 drunj të njomë në B. të Diellit me sëpatë. Nuk mundem assesi të kuptoj pse dikush e bën këtë. Marre! Lus qytetarët ta thërrasin menjëherë policinë kur vërejnë diçka të tillë ose komunën në 080012233", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".

# Zhbllokohet kanalizimi në Runik të Skenderajt



SKENDERAJ, 5 GUSHT (ER) - Pas përpjekjeve të vazhdueshme të punëtorëve për ta rregulluar çështjen e bllokimit të kanalizimit në afërsi të shkollës në Runik, në një nga bashkësitë më të mëdha lokale të Skenderajt është arritur më në fund zhbllokimi i kanalizimit i cili ka qenë i mbushur me mbetje asfalti gjatë kohës së asfaltimit. Një sasi e madhe e copave të asfaltit është nxjerr nga puseta e kanalizimit, duke e bërë të rrjedhin normalisht ujërat e zeza.

Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, vetëm pak ditë më parë përmes një njoftimi publik ka bërë me dije se nuk do të fillohet asfaltimi i rrugëve para se të bëhet mbikëqyrja dhe verifikimi i punëve fillestare në përputhje me projektet. Jashari i ka ftuar edhe qytetarët të bashkëpunojnë me organet komunale me qëllim të denoncimit tek autoritetet për çdo vërejtje që besohet se punimet nuk po kryhen sipas standardeve të parapara.

## Fillon mirëmbajtja e rrugëve në Komoran



DRENAS, 5 GUSHT (ER) - Ka filluar së zbatuari projekti për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonit veror në Komoran, projekt ky i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës. Gjatë realizimit të këtij projekti ka qëndruar afër drejtoresha e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, Lumnije Krapi, e cila ka thënë se tani edhe Komorani si zonë urbane do të ketë pastrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonit veror. Në kuadër të këtij projekti do të bëhet larja e rrugëve dhe pastrimi i tyre, ndërsa punimet do t'i kryejë ndërmarrja "Pastrimi". Banorët e Komoranit e kanë mirëpritur këtë projekt i cili do të ndikojë në mirëmbajtjen e rrugëve dhe pastrimin e tyre në sezonin veror.

Komuna e Drenasit këtë projekt është duke e zbatuar edhe në qendër të Drenasit, kurse tani e ka shtirë edhe në Komoran. Projekti për menaxhimin e mbeturinave është i shtrirë në të gjitha vendbanimet.

# A do ta shesë Kosovën Hashim Thaçi



Bedri ISLAMI

Në të gjithë këto ditë, pas një deklarimi të presidentit të Kosovës për korrigjimin e kufijve është ndezur, ndoshta me të drejtë, një debat i pafund rreth kësaj teze, e cila, si jam i bindur, kurrsesi nuk mund të jetë vetëm ide e Hashim Thaçit. Po ashtu, dua të besoj se, si ndodh zakonisht në nënzërat e politikës, ai duhet të ketë marrë një mendim nga strukturat që e mbështesin në botën e politikës. Dhe këto struktura janë të njohura.

Por, edhe sikur të ishte mendim vetjak i tij, ai, si po alarmohen analistët dhe njerëzit e politikës opozitare në Shqipëri, por edhe në Kosovë, as nuk e vendosi këtë, as nuk i vuri zjarrin kontinentit të vjetër, dhe as nuk ka fuqi të hapë atë që quhet Kutia e Pandorës.

Sidoqoftë unë e them haptas: nëse Ai arrin të bëjë atë çfarë ka në mendje, kthimin e Kosovës Lindore si pjesë integrale të Kosovës, le të hapen 100 kuti pandorash, të cilat janë mbyllur një mijë herë për vendin tonë dhe gjithnjë në dëm të tij. Mendimi i një politikani lëseist, se "kufijtë janë mirë", është naiv pasi, pas këtyre kufijve, shumë nga shqiptarët që bëjnë pjesë në shtetet rrethuese, sidomos në Kosovën Lindore, janë në prag të asgjësimit si pjesë formuese: ata po shpërngulen me dhunë, po mohohen të drejtat dhe vetë jeta e tyre është në rrezik.

Por të kthehem tek ideja e këtij shkrimi, "A do ta shesë Kosovën Hashim Thaçi"?

As Hashim Thaçi dhe askush tjetër nuk është sot zot i Kosovës dhe mbinjeriu që vendos për fatin e saj. Edhe nëse, në rastin më të hidhur, ai provon të bëjë lëshime mbi hartën e Kosovës, sado të vogla të jenë ato, përgjegjësinë historike dhe ndëshkimin kohor do ta marrë vetëm ai, por sigurisht se asgjë e tillë nuk do të mund të kalojë përmes Kuvendit të Kosovës dhe institucioneve të saj.

Ka shumë zëra se e gjithë kjo që po ndodh aktualisht në Kosovë, pra përplasjet dhe përdallimet e mëdha të klasës politike dhe rolit të Thaçit kanë të bëjnë me lëshimet e këtij të fundit ndaj strukturave euroatlantike për të qenë i sigurt se ndaj tij nuk do të veprojë Gjykata Ndërkombëtare, e njohur si Gjykata Speciale, e cila tani mund të ketë filluar t'i mbyllë dosjet e saj.

Të bësh politikë përmes një teze të tillë dhe të synosh të bësh të kapshëm mendimin se lëshimet e Thaçit kanë të bëjnë me "ruajtjen e kokës së tij" do të thotë që nuk ke kuptuar dy gjëra themelore: që bashkësia ndërkombëtare po vepron kundër Kosovës, përderisa kërkon lëshime politike e territoriale dhe, e dyta, të mos e njohësh mekanizmin që është vënë në lëvizje nga drejtësia ndërkombëtare, e cila, jo si në Kosovë e kurrë si në Shqipëri, nuk është institucion politik, nuk varet nga shefat e shteteve dhe as nuk do t'ia dijë se çfarë lëshimesh është i gatshëm të bëjë Hashim Thaçi.

Nëse ndaj tij, si ndaj kujtdo tjetër në Kosovë, ka fakte dhe saktësi se me emrin dhe luftën e tij janë të lidhur edhe krimet të ndryshme, kjo nuk ka të bëjë aspak, në asnjë çast, me lëshimet ose idetë që ka ndërmend presidenti i Kosovës.

Vetëm ata që në rrethana të ndryshme kanë bërë lëshime të tilla, qoftë politike, qoftë kombëtare, për më shumë hapësirë politike e jetësore, e perceptojnë Gjykatën Ndërkombëtare si një han ku futet e del secili që mbron apo dënon politika jashtë Kosovës.

Presidenti Hashim Thaçi nuk ka tagër të shesë asnjë metër katror të Kosovës. As të ndërrojë kufijtë e saj në rrudhjen e tyre. Dhe as nuk synon të bëjë këtë. Në mos tjetër, ai e di fare mirë që mbi fatin e tij, jo vetëm politik, por edhe mbi investimin e shkuar, varet një darë e fuqishme, përmes së cilës nuk mund të luash me asgjë tjetër, veç dobisë për shtetin tënd.

Kosova nuk është çiflig as i Thaçit, as i Mustafës, as i Haradinajt dhe as i Veselit. Ata e kanë radhën tani të qeverisin, por kjo nuk do të thotë se janë të përjetshëm në qeverisjen e tyre. Më mirë se gjithë të tjerët, këtë e dinë ata vetë.

Ata, secili prej tyre, është e mundur të luajnë me prona dhe tenderë, të vënë pasuri dhe të shpërrallisin për patriotizëm por, shumë herë më tepër se një klan opozitar përreth tyre, ata, të cilët drejtojnë sot tre institucionet më të rëndësishme të Kosovës, në të shkuarën kanë dëshmuar më tepër përkushtim sesa disa "trima lëdëkëistë", të cilët në kohën e pushtetit të tyre e kishin për nder të ishin pjesë e bashkim-vëllazërimit serbojugosllav.

Kosova është mbi të gjitha krijesë e shteteve perëndimore dhe e politikës së tyre për Ballkanin. Duke u nisur nga lufta që ndodhi në Kosovë dhe, pa këtë luftë nuk do të kishte ndërhyrje euroatlantike, ata synuan dhe arritën disa gjëra njëherësh, njëri nga të cilët do të ishte vendosja e kufirit të influencës ruse në kufirin verior të Kosovës.

Në rreth 20 vjet shtetet perëndimore kanë investuar më tepër nga sa është pritur dhe kanë ngritur një shtet, ndonëse çalaman për jo fajin e tyre deri në fund, i cili nuk ka as luksin, as dobësinë për të falur në paqe atë që është fituar me luftën e përbashkët.

Çështja e Kosovës, megjithëse është shtruar në një tryezë dypalëshe, nuk është vetëm e tillë. Ajo, në paskenat e saj, ka aktorë të tjerë, të cilët nuk kanë menduar vetëm sot për tezën e Presidentit të Kosovës dhe jo nga dita e sotme po synojnë për të realizuar një sovranitet gjithnjë e më të fuqishëm.

Ka të dhëna të plota se ajo që po diskutohet sot mes dy përfaqësuesve shtetërore është rrahur shumë herë në kancelaritë euroatlantike, është hapur jo vetëm si temë e nxehtë, por edhe si opsion për zgjidhje mes shteteve me qëndrime jo të njëjta, për të ardhur në këto ditë, kur gjërat po nxehen gjithnjë e më shumë dhe kur pritja bëhet e padurueshme.

Tagri i Hashim Thaçit është të përfaqësojë Kosovën në këto bisedime. Qëndrimi i opozitës që presidenti i Kosovës të mos jetë drejtuesi i tyre, sado gabime mund të ketë bërë Thaçi në të shkuarën dhe ai ka bërë, është si të kërkosh t'i lash duart dhe nesër të dalësh me teza nacionaliste, sikur vetëm qenia e tyre do të sillte një Kosovë dy herë më të madhe.

Të mos bëhemi të paditur: rolin e prijatarit, duam apo nuk duam, Hashim Thaçi e ka marrë edhe kur ka qenë ndoshta i panjohur, si në Rambuje, e jo më sot që është në postin më të lartë të institucioneve të Kosovës.

Nëse opozita ka drojën se Thaçi mund të bëjë lëshime në dëm të Kosovës, është më e frytshme të jenë aty, ta ndalojnë në kohën e duhur dhe, nëse ai nuk do të kishte zgjidhje tjetër, ata të bëjnë të mundur përballjen e tij masive me opinionin publik.

Politika për Kosovën bëhet më shumë jashtë Prishtinës sesa në Prishtinë. Ajo i ka rrënjët nganjëherë shumë larg saj dhe nuk janë nga ato rrënjë që mund të lëvizin nga dëshira e një njeriu të vetëm, qoftë ky edhe presidenti i Kosovës.

Kosova e ka shpallur pavarësinë me propozimin e Kuvendit të saj dhe jo pa mbështetjen e atyre shteteve që qëndrojnë sot mbështetës të qëndrimit të shtetit të pavarur të Kosovës, pa i hequr asaj asnjë pjesë tokësore.

Si duket, mesazhi i ardhur nga Thaçi mund të jetë i nisur nga shumë larg, aq më tepër kur ai shoqërohet edhe dy mesazhe të tjerë, të cilët, analistët dhe opozita në Shqipëri, as nuk ka dashur dhe as nuk do t'i lexojë: nuk do të ketë ndryshime kufijsh, nuk do të jetë në diskutim asnjë metër katror tokë e Kosovës, pra nuk do të ketë ndarje.

Do të ketë përpjekje për një rishikim të kufirit. Nëse Thaçi e arrin synimin e tij, atëherë do ta ketë hak kujtesën e vendit të tij, do t'i harrohen mjaft gabime që ka pasur në rrugëtimin e tij politik; nëse e gjithë kjo është një shashkë vetëm e tij, atëherë përgjegjësia do të jetë vetëm e tij. Dhe më tepër se kaq, do të jetë një faj dhe fajet paguhen.

Ajo për të cilën bëhen merak analistët duke i qarë hallin gjithë botës, Kutinë e Pandorës së kufijve, nuk është në dorën e Hashim Thaçit, as të hapet, as të mbyllet e, as të hapet paksa, veç për Kosovën.

Në fund më lejohet të sjell fjalët e një miku tim, jashtëzakonisht të vyer, të cilit i kam besuar dhe do i besoj gjithnjë, pjesë e hershme e lëvizjes çlirimtare, i cili vjen pikërisht nga trevat e Kosovës Lindore, Halil Selimi.

Ai shkruan se:

Presheva kërkon trajtim serioz dhe zgjidhje politike të mirëfilltë.

Vetëm rikthimi në Kosovës është zgjidhje.

Mos të guxojë askush të tallet publikisht e as fshehtas me të drejtën historike, kombëtare dhe politike të një krahine dhe të një popullate të tërë, etnikisht e territorialisht pjesë integrale e Kosovës, padrejtësisht e shkëputur nga tërësia territoriale gjithështqiptare.

Nuk i lejohet askujt që të vazhdojë ta përdorë Luginën e Preshevës si strehim apo mashtrim politik, e cila, pikërisht si pasojë e mashtrimeve të vazhdueshme historike për kusuritje, edhe ka mbetur deri sot nën Serbi.

Lugina e Preshevës (Kosova Lindore) ka mbajtur një referendum gjithëpopullor më 1-2 mars 1992, ku shprehet qartë vullneti politik për Autonomi politike-territoriale, me të drejtë bashkimi me Kosovën.

Kush është rizgjuar kombëtarisht dhe politikisht, le të mbështesin vetëm këtë vendim plebishitar të kësaj popullate liridashëse, pa spekulime politike apo interesa individuale, kushdo dhe kudo qofshin ata.

Me mendimin e tij bashkohem plotësisht.



## Presidentja kroate shënon përvjetorin e operacionit "Oluja"

ZAGREB, 5 GUSHT - Udhëheqës shtetërorë kroatë kanë deklaruar se operacioni "Oluja" ishte madhështor dhe fitorja më e madhe në historinë kroate. Këto deklarata ata i bënë në Knin, me rastin e 23-vjetorit të kthimit të kontrollit të pjesëve të Kroacisë, të marra nga serbët në fillim të vitit 1991. Presidentja Kolinda Grabar Kitaroviq gjatë fjalimit të saj ka theksuar se do të përkrahin Bosnjë e Hercegovinën në rrugën drejt BE-së.
Ndërsa kryeministri Andrej Plenkoviq një pjesë e mirë të fjalimit të tij iu ka dedikuar marrëdhënieve me Serbinë. Serbët kishin deklaruar pavarësinë e tyre nga Kroacia, duke shpallur Republikën Serbe të Krajinës, e cila kishte mbetur e panjohur ndërkombëtarisht.
Më 4 gusht të vitit 1995 sulmi ka nisur me 150 mijë trupa kroate, të cilat shpejt kanë thyer linjat e Ushtrisë serbe në Krajinë, për të avancuar drejt Kninit.
Në ditën e dytë të operacionit, forcat serbe janë shembur dhe pjesa më e madhe e Ushtrisë së Jugosllavisë është tërhequr. Forcat kroate kanë rikthyer rajonin për katër ditë, duke i dhënë fund operacionit më 8 gusht. Operacioni është cilësuar si ofensiva më e madhe tokësore në Evropë që prej Luftës së Dytë Botërore. Në të janë vrarë qindra serbë, ndërsa mijëra të tjerë kanë braktisur shtëpitë.



# Trumpi sulmon donatorët e pasur të politikës amerikane

Presidenti amerikan Donald Trump sulmoi këtë javë miliarderin donator të republikanëve, Charles Koch, duke rikthyer kështu vëmendjen ndaj influencës së donatorëve të pasur në politikën amerikane

UASHINGTON, 5 GUSHT - Presidenti Trump sulmoi rishtazi nëpërmjet "Twitter"-it miliarderin donator të republikanëve, Charles Koch, duke rikthyer kështu vëmendjen ndaj influencës së donatorëve të pasur në politikën amerikane. Këtë javë pati një tjetër sulm në "Twitter" nga presidenti Trump. Objektivi ishte Charles Koch, një ndër mbështetësit më të pasur të kandidatëve republikanë. Gjatë një takimi në shtetin Kolorado, Koch kritikoi politikat tregtare të administratës Trump. "Kur njerëzit veprojnë në mënyra proteksioniste, ata ngrenë barriera që janë keq për të gjithë", u shpreh Koch.
Tregtia është një pikë fërkimi e fortë mes presidentit Trump dhe Koch, në veçanti lufta e tarifave që po zhvillohet mes Uashingtonit dhe partnerëve tregtarë, sidomos me Kinën.
"Presidenti dhe 15 drejtues të administratës së tij kanë thënë vazhdimisht se do të dëshironin ndaljen e praktikave të padrejta tregtare. Por, derisa të ndodhë kjo, presidenti do t'ua mbajë shputat mbi zjarr. Ai do ta vazhdojë presionin ndaj Kinës", deklaroi Sekretarja e shtypit e Shtëpisë së Bardhë, Sarah Sanders.
Lufta Trump - Koch nxjerr në pah influencën e donatorëve të pasur në politikën amerikane.
Rrjeti Koch, një burim shumë i madh mbështetje financiare, është i përbërë nga një grup organizatash që përgjithësisht mbështesin politikat e republikanëve për më pak taksa dhe më pak ligje shtrënguese. Për zgjedhjet e mesmandatit të muajit nëntor, rrjeti Koch planifikon të shpenzojë deri në 400 milionë dollarë. "Njëqind donatorët kryesorë përballojnë rreth 3/4-at e fondeve që shkojnë drejt vetëm njëqind individëve", shpjegon Robert Weissman, president i "Public Citizen".



Weissman dhe aktivistë të tjerë besojnë se korporatat dhe individët e pasur, si Koch, influencojnë në mënyrë disproporcionale zgjedhjet amerikane në interes të agjendës së tyre. Zgjedhjet në Shtetet e Bashkuara financohen publikisht dhe privatisht. Kontributet private për fushatat elektorale jepen nga individë dhe grupe, si korporatat dhe sindikatat. Megjithëse është e jashtëligjshme t'i jepen fonde drejtpërsëdrejti një kandidati, individë donatorë lejohet t'i japin deri në 2 700 dollarë organizatës së kandidatit, si dhe mund të japin pothuajse fonde pa limit nëpërmjet komiteteve të aksionit politik.
Nëse një kandidat fiton, pritshmëria është që kandidati do t'i mbështesë politikat e agjendës së donatorit, megjithëse nuk ndodh gjithnjë kështu. "Pasi zgjidhen, e kanë mendjen te zgjedhjet e ardhshme. Dhe mendojnë si t'i kënaqin donatorët e pasur që ua mundësuan postin dhe të cilët mund edhe t'i heqin nëse nuk kënaqen interesat e tyre", thotë Weissman.
Ky sistem, të cilin kritikët e quajnë "paguaj që të marrësh pjesë në lojë", është krejtësisht i ligjshëm, në veçanti pas një vendimi të Gjykatës së Lartë në vitin 2010, të njohur si çështja e "Qytetarëve të bashkuar". Gjykata vendosi se korporatat kanë të njëjtat të drejta politike të lirisë së fjalës ashtu si individët, dhe se nuk duhet të ketë kufizime ndaj fondeve që ato shpenzojnë për të mbështetur apo denoncuar kandidatët në zgjedhje.
Që nga ky vendim, shumat e kanalizuara nëpërmjet komiteteve të aksionit politik nga grupe si rrjeti Koch, kanë përjetuar një rritje drastike.

# Pompeo përfundon turneun në Azinë Juglindore



UASHINGTON, 5 GUSHT - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, përfundoi turneun e tij të Azisë Juglindore. Para se të nisej të dielën, ai u takua me presidentin indonezian Joko Widodo, të cilit i tha se Shtetet e Bashkuara vlerësojnë lidhjet me Indonezinë, një nga demokracitë më të mëdha në botë.
Të shtunën diplomati i lartë amerikan u takua me homologun e tij indonezian Retno Marsudi. Sekretari dhe ministri i Jashtëm diskutuan mbi bashkëpunimin dypalësh dhe angazhimin rajonale të sigurisë, duke përfshirë Korenë e Veriut dhe kundërterrorizmin si dhe çështje të tjera të politikës së jashtme me interes të përbashkët.
Pompeo mbërriti në Xhakarta të shtunën nga Singapori ku pati mesazhe kontradiktore mbi marrëdhëniet mes Shteteve të Bashkuara dhe Koresë së Veriut për bisedimet mbi de-nuklearizimin. Në avion për në Xhakarta, zëdhënësja e Departamentit të Shtetit, Heather Nauert, u tha gazetarëve se sekretari Pompeo dhe ministri i Jashtëm i Koresë së Veriut, Ri Yong Hu, iu afruan njëritjetrit gjatë seancës për "foton familjare" dhe shtrënguan duart.
Pompeo tha se "ne duhet të flasim përsëri së shpejti", ndërsa ministri i Jashtëm i Koresë së Veriut, Ri Yong Hu, u përgjigj: "Dakord. Ka shumë biseda produktive që duhen bërë".
Pas kësaj, ambasadori amerikan në Filipine Sung Kim i dorëzoi Ri një letër nga presidenti Trump për udhëheqësin e Koresë së Veriut, Kim Jong Un. Përmbajtja e letrës nuk u bë e ditur.

## Presidenti i Venezuelas i mbijeton sulmit me eksplozivë nga droni

KARAKAS, 5 GUSHT - Presidenti i Venezuelas, Nicolas Maduro, tha se i ka shpëtuar një tentim-sulmi me eksplozivë nga droni. Gjatë fjalimit të tij në një ceremoni ushtarake në Karakas, dy dronë të mbushur me eksplozivë u nisën me cak te presidenti.
Maduro më vonë iu adresua popullit duke thënë se "një shpërthim ndodhi shumë afër meje, pak sekonda më vonë ndodhi edhe shpërthimi i dytë". Disa fotografi në rrjete sociale shfaqin rojet e presidentit duke u kujdesur për sigurinë e tij. Presidenti ka fajësuar Kolumbinë për sulmin, gjë që u kundërshtua nga Bogota duke e quajtur akuzë të pabazë.



Kush e urren Adem Demaçin e urren vetveten (2)

# Adem Demaçi nuk e ka urryer kurrë Ibrahim Rugovën

*(Shkruar në orën 21:00, pasi u mbyll e pamja për Adem Demaçin, më 31 korrik 2018)*

Prof. dr. Hakif BAJRAMI

Adem Demaçi shpirtërisht e ka respektuar Ibrahim Rugovën, sidomos deri më 1 tetor 1997. Po e ka kritikuar sepse ka aspiruar që presidenti Rugova t'i mbathë çizmet dhe ta marrë komandën supreme me çka bota do të mësonte se një popull i tërë është ngritur me armë për luftë të drejtë. Pra, pozita e komandantit suprem për Adem Demaçin ishte princip dhe kriter real, sepse askush pa i rrokur armët nuk të ndihmon, as nga Lindja, jo se jo, por as nga Perëndimi, ku e kishim shpresën dhe orientimin politik dhe civilizues, sepse jemi evropian den baba den.

Në këtë rrafsh Adem Demën e gëzoi shumë fakti se KS i OKB-së më 31 mars 1998, tre muaj pas daljes publike të UÇK-së, u aprovua njëzëri rezoluta nr. 1160 ku, ndër të tjera, kishte mbështetje në kaptinën e VII (nenet 39-52) të Kartës së OKB-së, sidomos kur ishte në radhë neni 43, që do të thotë bombardime, gjithnjë duke u bazuar në intervenimin në Kroaci dhe në Bosnje. Mu për këtë, Baca e konsideronte shkuarjen në Rambuje një lojë të vjetër, të re evropiane. Këtë konfirmim e kishte nga goja e disa liderëve primarë në ShBA, fakt ky që duhet ta thonë ata. Lidhur me këtë Adem Dema e kishte të freskët shembullin e Kroacisë dhe të Bosnjës dhe nuk besonte se Milloshi do të jetë "civilizues" ndaj Kosovës, posaçërisht duke u bazuar në atë çka kishte ndodhur në Srebrenicë, zona këto në besë të OKB-së, aq më parë kur nga informatorët e tij kishte informatën për planin "Patkoi" të Milloshit që po i krijonte "korridoret përpalsëse" të cilat i paralajmëroi me kohë Kiro Gligorov. Ndaj këtij paralajmërimi paria jonë politike në vend se të heshtte kërkonte që Interpoli ta hetojë UÇK-në. Ku jeni shqiptarë, pse e fyeni Adem Demaçin, kur rreth një milion shqiptar u deportuan. Ky konceptim u forcua për Adem Demaçin, kur e lexoi dhjetëpikëshin e panegociueshëm, ku sovraniteti i Jugosllavisë mbi Kosovën ruhej, ku mbeteshin mbi 1 1000 forca ushtarake dhe policore, ku kufiri me Shqipërinë ruhej sidomos kah Shqipëria nga armata Jugosllave. E dihet se Adem Demaçi kishte bërë burgje dhe kishte themeluar UÇK-në në saje të ndihmës së nënës Shqipëri, pikërisht ashtu si e kishte mësuar nëna Nazife dhe mësuesja Vezire - Shqipëria.

## Baca fizikisht shkoi, a do të kemi bacë tjetër?

Isha në të pame për Bacën sepse e kisha shef 30 vjet dhe ia kisha borxh njerëzor si një ndër këshilltarët e tij. Ditën e 30 korrikut 2018 erdhi një ish-nxënës i imi i Gjimnazit (tash funksionar i lartë në Qeverinë e Republikës së Kosovës) në pamje me një grup burrash modestë. Foli ashtu si e do zakoni. Kur u ngre, besova se si ish-profesor i tij do të më drejtohet personalisht për ngushëllime, sepse në gjimnaz kur ishte nxënës kisha guxim ta propagandojë jo vetëm Adem Demaçin, Atë Fishtën, por edhe kur recitohej himni shkollor: "Gaudeamus igitur", ku thuhej "vivat profesores, vibat Respublika..." si ndër hundë ia shtoja sufiksin e Kosovës. Nuk ka faj, thashë se e ka trullosur pushteti, por jo pasuria se atë ka ditur ta bëjë.

Dhe e lodha mendjen duke e pyetur vetveten: A më e madhe është pasuria e shqiptarit më të pasur sot në botë, plus pushteti, apo pasuria e Adem Demçit, që nuk ka pasuri materiale fare. Nuk pata nevojë të mendoj shumë. Pasuria materiale e çdokujt mund të shuhet nga ndonjë e papritur natyrore, nga ndonjë keqmenaxhim prej tij apo pasardhësve. Pasuria e Adem Deamçit nuk mund të shuhet nga asnjë e papritur natyrore, as nga pasardhësit, as nga të gjithë shqiptarët sepse, nëse ne nuk e përvetësojmë, do ta marrin kombet e civilizuara. Ajo pasuri është e dukshme dhe merret fal, si gjenialiteti i Aristotelit, Mikelanxhelos, Skënderbeut, Galileut, Ajnashatjnit, Tesllës, Edisonit, Keplerit, Kopernikut, Khajamit, Gandit… Nënë Terezës, sepse kjo pasuri është në tregun e humanizmit dhe luftës së drejtë, kudo në glob.

Në të njëjtën ditë erdhën për kreshendosh edhe dy kryetarë komunash të Kosovës së bashku: Kryetari i Skenderajt dhe kryetari i Drenasit me shokë shumë. U printe me gëzimin tim djali i Hamëz Jasharit. Foli si burrat dhe thashë: Heroi Hamëz Jashari nuk paska ndërruar jetë, aq më parë kur Drenica heroike e kishte renditur të parin. Ju lumtë! Nja një orë më vonë erdhi pa protokoll, pa politikë, Rifat Jashari.

Foli edhe ky. Fjalë pak dhe domethënie brilante burrërie. Dhe, më lindi pyetja? Kush do ta zëvendësojë Bacën, të paktën si legjendë?!

Sikur e gjeta në bujarinë arbërore të Rifat Jasharit dhe shumë u gëzova si fëmija se do ta kemi dhe duhet ta promovojmë një Bacë shumë më të vogël, por Bacë sepse familja dhe sjellja arbërore bujare atë siguron.

Koha për dituri dhe nevoja që të kemi vatan ishte luftë e drejtë paralele, e pandarë.

Më 1945 në viset e robëruara shqiptare filloi seriozisht lufta për arsimim. Ajo luftë nuk ka qenë e lehtë, nga Abetarja e përkthyer deri tek universiteti dhe akademia e institutet shkencore. Ishte kjo luftë e veçuar sepse femrës, sidomos i jepej shansi të dalë nga robëria e dyfishtë. Nga ajo robëri na kanë nxjerrë mësuesit trima dhe të palodhshëm, librat dhe romanet e para shqip. Sidomos na ka zgjuar efektshëm romani i ndaluar "Gjarpijtë e gjakut", lexuar pjesë-pjesë në "Jeta e re" e famëlartit Esat Mekulit. Nga ajo shkollë kemi dalë të gjithë. Pas ndalimit u bë libri më i lexuar për dekada, ilegalisht, dorë pas dore.

Më 1 shtator 1969 kisha shkuar në Gjimnazin e Podujevës për të punuar si profesor i historisë. Ishte gëzim për mua si ish-nxënës gjimnazi të jam profesor, si Zekeria Rexha, si… Më 27 nëntor në mbrëmje do të mbahet një mbledhje dhe aty dy politikanë të komunës së Podujevës do të ma shtinë ndër hunde se "po kritikoj si Adem Demaçi"!

Mendova e meditova dhe pas dhjetë ditësh e lëshova punën dhe u punësova në Gjimnazin e Prishtinës, ku drejtori ishte një patriot, ku i kisha disa profesorë shokë, shumë të përkushtuar ndaj çështjes kombëtare. Aty, pas tre muajsh, do të ngrihet një serbian dhe do të na thotë në mbledhje të arsimtarëve: "Prof. Tahir Abdyli, prof. Rifat Blaku dhe prof. Hakif Bajrami kanë qenë në demonstratë më 27. XI. 1969 në Prishtinë".

Drejtori Fazli Syla, pa një pa dy, do t'ia kthejë: "Po, por me detyrë (Da, ali po zadatku!)" duke e drejtuar gishtin kah gjoksi i vet.

Ishte ky prof Fazli Syla. Me kaq nga drejtori autoritativ dhe zot i vërtetë i shtëpisë, akuza u mbyll. Kur dolëm nga mbledhja në kalim e sipër drejtori Fazli Syla si në "tallje" na tha: "More problema, tjera herë kur të dilni mos shkoni pa mua, bre dertin jua kajsha"! Dhjetë vjet më vonë (15 janar 1979) kur e kisha marrë gradën doktor shkence në histori, prindi Fetah Bajrami do të më thotë: "Shkollë keni ba mjaft, por vatan atje ku po ju thërret Adem Deamçi nuk keni ba ende!"

U stepa. Nga viti 1983 po ai prind i pajtuar me nënën do ta ruajnë kseroksimin e dosjes Demaçi në magje të miellit. Dhe kur e pyeta a ka dobi për vatanin ruajtja e dosjes, më tha: "Po, ruaju, ke tash pozitë drejtori, por: shkau të blenë në pranverë, të mjelë verës, të pretë në vjeshtë e të hanë dimrit. Vatani i lirë dhe shkolla e Demaçit ta sigurojnë që shkau as mos me të ble, as mos me të mjelë, as mos me të pre e as mos me të hangër". Mësoni shqiptarë, nuk ka ardhmëri pa këtë shkollë të përvojës popullore - kombëtare.

Kapitalin jetësor të Adem Demës duhet ta përvetësojmë. Baca diku e kishte lexuar se ilirët nuk kanë pasur skllavoprinari fare, sepse fisi nuk donte ta shtypte asnjë anëtar, e sidomos kujdeseshin për fisin tjetër që të jetojnë në miqësi. Së dyti, mësonte Baca shqiptarët nuk e kanë përjetuar kapitalizmin fare,



sepse koha po tregon se duke mos pasur si pasojë ndarjen territoriale, treg kombëtar ku plasohet malli dhe i konkurron mallit tjetër, ne kombëtarisht jemi vonuar. Së treti, kritikën, opozitën, duhet ta kuptojmë si pasuri civilizuese e jo si urrejtje. Unë (Baca) i kritikoj dhe më kritikojnë. Por, kjo nuk do të thotë më e shti ndër besë kritikuesin. Ejani ta marrim sikur tërë bota, nga kritika të dalim më unikë dhe më dinamikë në jetësimin e çështjes sonë kombëtare dhe civilizuese.

Baca Adem Demaçi i shtypur deri më 1958; tmerrësisht i shtypur dhe i torturuar në burgje për 28 vjet; tmerrësisht i injoruar dhe anatemuar prej shqiptarëve, por edhe atyre që diktojnë me zarfe, prapë mbetet shkollë që mendon, flet dhe vepron për pajtim që nesër të jemi më të lirë dhe më të lumtur.

## Si u shkatërrua katrahura Jugosllavi?

Adem Demaçi është figurë tredimensionale që ka gjatësi, lartësi dhe gjerësi. Me një anë është shkatërrues i madh. Ja çfarë i thotë hetuesit kur thjesht e lutë: "A mendon për vete dhe për familjen tënde?" Baca: "Ju mendoni vetëm për shkatërrimin tuaj"! Mjaft për një epokë lufte që u zhvillua me emrin e tij.

Në bazë të dokumenteve që i kam konsultuar me shenja rezervat në arkivin e LKJ-së, mund të konkludohet se ishin këta faktorë që e shkatërruan Jugosllavinë integrale dhe "homogjene" tititste dhe serbiane-çetnike. Së pari do të ishte diskutimi i Eduard Kardelit më 1957 në Beograd kur thotë: "Është e natyrshme që ne sllovenët një ditë të shkojmë kah Austria dhe Italia sepse andej na drejton kultura; ju serbianët do të shkoni kah bota ortodokse sepse andej ju peshon kultura; Qosiqi nga salla e shqiptarët? Kardeli: Natyrshëm që shqiptarët një ditë do të bashkohen me Shqipërinë".

Faktori i dytë pas aprovimit të Kushtetutës 1974 është kërkesa implicite që komanda ushtarake tutje të jetë në sllovenishte, në kroatishte, në serbishte, në maqedonishte, në shqipe për shkak të numrit të madh të rekrutëve. Kaq kësaj radhe.

Faktori vijues është sëmundja e Titos dhe "pëshpëritjet" kush do ta zëvendësojë. Si zëvendësues i parë përmes LKJ-së aspironte të jetë kriptokomunisti Staane Dollanc; si zëvendësues i parë përmes APJ-së aspironte të jetë Nikolla Lubiqiq. Ky e kishte bekimin serbo-malazez dhe maqedono-boshnjak. Nuk e kishte bekimin shqiptaro-hungarez.

Faktori i katërt do të bëhet evolutivisht kryesori e që është përplasja e shqiptarëve me pushtetin kolonial jugosllav, e që simbolikisht fillon me dukjen e LRBSh-së por, de fakto, më 27 nëntor 1968 me demonstratë shqiptare, e që kjo kohë si epoka e Adem Demaçit mbaron më 10. 6. 1999, kur "tallkinin" e fundit ia këndoi UÇK-ja dhe NATO-ja.

Për këtë shkollë ka jetuar dhe punuar baca Adem Demaçi, Mendela i shqiptarëve të robëruara nën Jugosllavi. Pra, katrahura Jugosllavi ka shkuar në pakthim në muze. Vepra e Adem Demaçit është në rritje dhe lulëzim, sepse është luftë e drejtë, model ky që i frikësohen shumë regjime, por para tij tani për tani po dridhet edhe kontinenti i vjetër e lërë më kontinentet e tjera, edhe pse këtë frymë e djathta ekstreme po e lufton kudo, por "fLladi" nacional ka filluar puhinë, këndshëm, lehtë, por sigurt, sikurse politika e Adem Deamçit. Le ta mbulojë botën sepse është në interes të shëndetit të njeriut, të lirisë dhe barazisë, sovranitetit dhe ardhmërisë. **(Fund)**

*Prishtinë, më 31 gusht 2018*

# Çfarë duhet të pini, për të shuar etjen dhe t'u dobësuar!

**Pijet në verë na ndihmojnë të luftojmë kundër nxehtësisë, të hidratohemi siç duhet dhe të mos zihemi me peshoren**



Sigurisht që kur bën shumë nxehtë duhet të pimë më shumë. Ekuacioni është matematik dhe duhet të respektohet me kujdes nëse nuk duam të pësojmë shqetësime të dëmshme dhe të dëmtojmë shëndetin tonë. Por, pijet nuk janë të gjitha njësoj: për etjen e verës ju duhet të zgjidhni me mençuri pijet për të ruajtur ekuilibrin e trupit si dhe në të njëjtën kohë t'i shijoni.

**Uji** – Uji është gjithmonë zgjidhja më e mirë në të gjitha stinët. Nuk përmban kalori, kështu që ne mund ta shuajmë etjen tonë sipas vullnetit, duke e zgjedhur atë natyral ose të gazuar sipas shijeve tona. Pirja e ujit kullon lëngjet e tepërta, eliminon toksinat dhe e bën lëkurën të ndritshme dhe të hidratuar mirë. Përveç kësaj, gjithashtu ndihmon për të humbur peshë: zakoni i pirjes së dy gotave me ujë para se të ulemi në tavolinë rrit ndjenjën e ngopjes dhe ndihmon për të ngrënë më pak, e gjitha kjo në avantazh të linjave tona. Për t'i dhënë më shumë gjallëri, ju mund të shtoni disa pika lëng limoni dhe një fetë me fruta të freskëta: ajo do ta shuajë edhe më shumë etjen.

**Çaj i ftohtë: OK, por…** – Çaji në shishe dhe në përgjithësi ai i paketuar dhe i gatshëm për t'u pirë, shpesh është shumë i ëmbël. Ka një shije shumë të këndshme, por ne i kushtojmë vëmendje numrit të kalorive dhe shëndetit të dhëmbëve. Më mirë ta përgatisni në shtëpi me bustina, ftoheni dhe ruajeni në frigorifer në një shishe ose në një karak, kështu që gjithmonë do ta keni në dispozicion të freskët. Më mirë të mos i shtoni sheqer: kush ka vështirësi të bjerë në gjumë në mbrëmje, mund të zgjedhë versionet e dekafeinatos.

**Lëngje dhe ekstrakte** – Vlen i njëjti debat që bëmë më sipër për çajin: është më mirë të përgatitësh pije frutash në shtëpi. Lëngjet industriale zakonisht janë shumë të ëmbla: nëse nuk mund të heqim dorë praktikisht nga produkti i paketuar, është më mirë të preferojmë varietetet pa sheqer të shtuar. Por, në vend të kësaj ne mund të përgatisim lëngje frutash në shtëpi, nuk ka rëndësi nëse janë smoothies, të centrifuguar ose ekstrakte, ne jemi të sigurt që kemi siguruar një përzierje të shkëlqyeshme të vitaminave dhe mineraleve, që është e përsosur për të zëvendësuar ata që humbëm përmes djersitjes. Një smoothies i mirë ose një ekstrakt i frutave dhe perimeve është gjithashtu edhe një rostiçeri që mund ta shoqërojmë me një dolli ose një sanduiç të lehtë.

**Çajra aromatikë** – A kemi provuar ndonjëherë një përzierje të freskët me fruta të kuqe, boronica ose xhenxhefil? Çajrat bimore nuk janë të mira vetëm në muajt e dimrit, kur ne duhet të heqim të ftohtin nga eshtrat ose të trajtojmë të ftohtin: ato na ofrojnë një përzierje aromash të mira që ia vlen të eksplorohen për të zbuluar të preferuarën tonë. Nëse jemi kreativë, ne mund të shpikim përzierjen tonë ideale, për shembull duke shtuar disa feta pjeshke të përzier me boronicë dhe fruta të kuqe, shumë i përshtatshëm për kullimin e lëngjeve dhe lehtëson shumë këmbët që na rëndojnë: ju mund ta përzieni atë me ujë të nxehtë, pastaj filtrohet dhe ruhet në frigorifer. Ose mund të provoni një përzierje me kopër dhe gjethe të freskëta nenexhik, ndoshta me pak xhenxhefil, për t'i dhënë pijes një shije mahnitëse.

**Është koha e aperitivit?** – 'Ora e lumtur' është një takim shumë i parashikuar dhe shumë emocionues si në qytet dhe në pushime. Është gjithashtu një kohë e tundimeve të mëdha, duke përfshirë pije alkoolike, ushqime hiperkalorike dhe pijeve me shumë sheqer. Në qoftë se është shumë nxehtë, më mirë i shmangni pijet me alkool, të cilat rrisin ndjesinë e nxehtësisë, janë bomba kalorike dhe janë të këqija për shëndetin tuaj. Në vend të pijeve me sheqer, mund të shijoni një lëng natyral të mirë portokalli, ose limon me ujë mineral të gazuar (në mënyrë që të përfitoni nga limoni, mos i shtoni sheqer!). Agrumet janë të pasura me vitaminë C dhe minerale, shuajnë etjen dhe kanë pak kalori; limoni në veçanti, sidomos nëse konsumohet esëll në mëngjes, ka meritën e ribalancimit të bilancit alkalik të organizmit.

*(gazeta-Shqip.com)*

# Meghan vonon publikimin e albumit




Meghan Trainor ka njoftuar se albumi i saj i ardhshëm "Treat Myself" do të publikohet më vonë se që është pritur. Ky album ishte planifikuar që të publikohet më 31 gusht, por Meghan e ka shtyrë datën. Pesë këngë të shkëputura nga aty tashmë janë në dispozicion në imunes.



# Rita Ora 'ndez' Lituaninë

Nuk ka pushime për Rita Orën. Bukuroshja me prejardhje nga Kosova e ka kombinuar relaksin në pishina apo buzë detit me koncerte shpërthyese në Londër, Nju Jork, Milano dhe, së fundmi, është ndalur në Lituani. E veshur e gjitha me jeshile, Rita duket shumë seksi në fotografitë që ka ndarë me fansat në rrjetin social në "Instagram" para koncertit.

# Shqiptarët krenarë me Bebe Rexhën dhe Dua Lipën



Tashmë jemi dëshmitarë të shumë prej këngëtareve shqiptare me famë botërore, të cilat bëjnë krenarë shqiptarët kudo që janë. Të tilla janë Rita Ora, Bebe Rexha, Dua Lipa e Era Istrefi. Secila nga të lartpërmendurat janë të veçanta në stilin e tyre, e ndërsa ruajnë edhe një miqësi shumë të mirë mes tyre. Së fundmi, Bebe Rexha ka pasur rastin ta takojë Dua Lipën në Festivalin "Lollapalooza" në Çikago. Ajo ka publikuar një fotografi në llogarinë zyrtare në "Instagram", ku shfaqet përkrah çikës së Kosovës, ndërsa shihet mjaft e lumtur që është takuar me të.

# Puthje pasionante në mes të Beyonces dhe Jay Z



Çifti i njohur i skenës, Beyonce dhe Jay Z, kanë mbajtur së fundmi një koncert në New Jersey. Ky koncert ishte vonuar për pak për shkak të stuhisë, mirëpo gjithsesi fansat kanë pritur të gjithë deri në çastin kur dyshja u shfaqën në skenë. Ata kanë bërë një hyrje madhështore në skenë pasi ka përfunduar stuhia. Për ta bërë edhe më emocionuese performancën e tyre, Beyonce dhe Jay Z në një moment kanë shkëmbyer puthje pasionante me njëri-tjetrin.




# Madonna ndryshon jetën 60-vjeçe! Ylli i muzikës rrëfen gjithçka

Portugalia një burim frymëzimi. Këngëtarja e famshme do të transferohet në Lisbonë për të birin futbollist

Nëse do të jetë një jetë e re për yllin e popit kameleonik, që është në zemrat e të gjitha vajzave rebele, do ta shihni me kalimin e kohës. Fakti është se në moshën 60-vjeçare – që i mbush më 16 gusht – Madona ka provuar ndryshime. Jeton prej një viti në Lisbonë së bashku më fëmijët e saj: David Banda dhe Mercy James, 12 vjeç dhe binjakët Stella dhe Esther, 5 vjeç. Ylli i popit, në numrin e revistës Vogue Italia, zbulon arsyet për transferimin dhe tregon për jetën e saj të përditshme në kryeqytetin portugez.

"I thashë vetes: Le të shohim nëse për një vit mund të jetoj diku tjetër dhe t'i çoj katër fëmijët e mi në një mjedis të ndryshëm, sepse mendoj se është e rëndësishme t'i rrisësh fëmijët në kontakt me kultura të ndryshme. Djali im David, i cili më 24 shtator mbush 13 vjeç, dëshiron të bëhet futbollist profesionist. Zgjedhja ishte në mes Akademisë së Juventusit në Torino, Barcelonës dhe Benfikës ose Sportingut në Lisbonë. Shkova atje dhe u përpoqa të imagjinoj se si do të ishte të jetoje në këto qytete. Sigurisht, Barcelona është një qytet fantastik edhe Torino më pëlqen, por nuk më duket e përshtatshme për fëmijët. Është mirë për intelektualët, me të gjitha ato muze të bukura dhe ndërtesa mbresëlënëse, por unë nuk mendoj se fëmijët do të kishin argëtuar. Unë duhet të mendoj për të gjithë, nuk mund të marrë vetëm Davidin në konsideratë. Kështu shkova në Lisbonë dhe në përgjithësi më është dukur zgjedhja më e mirë. Portugalia është e zhytur në histori: perandoria e saj ka lënë shenjë në botë, arkitektura është e jashtëzakonshme. Dhe duke qenë gjithashtu vendi ku filloi skllavëria, ndikohet nga ndikimet muzikore të vendeve si Angola dhe Cape Verde, si dhe Spanja. Dhe në qoftë se kjo nuk mjafton, një nga aktivitetet e mia të preferuara është të kalëroj. Për të hipur shkoj në Comporta, ose në shtëpinë e një shoku, ose tek Alcácer. Ka shumë zona përreth ku mund të kalërosh dhe çdo herë që djali im nuk ka ndeshje të dielën, atëherë e shfrytëzojmë për të kalëruar".

Në intervistën me Vogue Italia, Madonna shpjegon se si përvoja e Lisbonës ishte gjithashtu një burim frymëzimi për albumin e saj të ardhshëm. "Unë gjithmonë them se Portugalia qeveriset nga tre f: fado, futboll dhe Fatima. Është gjithashtu një vend shumë katolik, gjë që është shumë mirë për mua. Më kujton Kubën, sepse njerëzit nuk kanë shumë, por hapin derën e çdo shtëpie, shkojnë në ndonjë rrugicë dhe gjithmonë dëgjon muzikë. Gjithmonë dëgjon shumë fado dhe kuduro, një zhanër muzikor anglez. Gjithashtu edhe shumë xhaz: një gjë e bukur. Kam takuar shumë muzikantë të mrekullueshëm dhe shumë prej tyre përfunduan duke bashkëpunuar në albumin tim të ri, kështu që Lisbona ndikoi në muzikën time dhe në punën time. E si mund të ndodhte ndryshe? E pamundur të kaloja një vit pa qenë e kushtëzuar nga gjithë kultura që më rrethonte".

Por jeta e nënës së një futbollisti, zbuloi Madona, nuk është fushë me lule. "Çdo grua që u kushton kohë të plotë fëmijëve të saj, që vjen dhe shkon nga fusha e futbollit, do të përgjigjej që në jetë nuk ka pse ndryshojnë gjërat nga javë në javë dhe nga fundjavë në fundjavë: nganjëherë ata janë në qytet, ndonjëherë jo, dhe deri të enjten në mbrëmje nuk e dimë nëse do të jenë të shtunën apo të dielën. Është e pamundur të organizohesh dhe pastaj ke ndjesinë e të qenit e padrejtë ndaj fëmijëve të tjerë, për të mos e llogaritur veten!"

Por, popstarja tregon që të gjithë fëmijët e saj janë përshtatur me ndryshimin. "Gjëja më e habitshme është aftësia e tyre për të kapërcyer çdo pengesë, për t'u zhytur në çdo gjë, në muzikë, vallëzim, në futboll dhe në sport në përgjithësi, aktivitete që i sjellin ata në kon-





Portugalia një burim frymëzimi. Këngëtarja e famshme do të transferohet në Lisbonë për të birin futbollist

Nëse do të jetë një jetë e re për yllin e popit kameleonik, që është në zemrat e të gjitha vajzave rebele, do ta shihni me kalimin e kohës. Fakti është se në moshën 60-vjeçare – që i mbush më 16 gusht – Madona ka provuar ndryshime. Jeton prej një viti në Lisbonë së bashku më fëmijët e saj: David Banda dhe Mercy James, 12 vjeç dhe binjakët Stella dhe Esther, 5 vjeç. Ylli i popit, në numrin e revistës Vogue Italia, zbulon arsyet për transferimin dhe tregon për jetën e saj të përditshme në kryeqytetin portugez.

"I thashë vetes: Le të shohim nëse për një vit mund të jetoj diku tjetër dhe t'i çoj katër fëmijët e mi në një mjedis të ndryshëm, sepse mendoj se është e rëndësishme t'i rrisësh fëmijët në kontakt me kultura të ndryshme. Djali im David, i cili më 24 shtator mbush 13 vjeç, dëshiron të bëhet futbollist profesionist. Zgjedhja ishte në mes Akademisë së Juventusit në Torino, Barcelonës dhe Benfikës ose Sportingut në Lisbonë. Shkova atje dhe u përpoqa të imagjinoj se si do të ishte të jetoje në këto qytete. Sigurisht, Barcelona është një qytet fantastik edhe Torino më pëlqen, por nuk më duket e përshtatshme për fëmijët. Është mirë për intelektualët, me të gjitha ato muze të bukura dhe ndërtesa mbresëlënëse, por unë nuk mendoj se fëmijët do të kishin argëtuar. Unë duhet të mendoj për të gjithë, nuk mund të marrë vetëm Davidin në konsideratë. Kështu shkova në Lisbonë dhe në përgjithësi më është dukur zgjedhja më e mirë. Portugalia është e zhytur në histori: perandoria e saj ka lënë shenjë në botë, arkitektura është e jashtëzakonshme. Dhe duke qenë gjithashtu vendi ku filloi skllavëria, ndikohet nga ndikimet muzikore të vendeve si Angola dhe Cape Verde, si dhe Spanja. Dhe në qoftë se kjo nuk mjafton, një nga aktivitetet e mia të preferuara është të kalëroj. Për të hipur shkoj në Comporta, ose në shtëpinë e një shoku, ose tek Alcácer. Ka shumë zona përreth ku mund të kalërosh dhe çdo herë që djali im nuk ka ndeshje të dielën, atëherë e shfrytëzojmë për të kalëruar".







Në intervistën me Vogue Italia, Madonna shpjegon se si përvoja e Lisbonës ishte gjithashtu një burim frymëzimi për albumin e saj të ardhshëm. "Unë gjithmonë them se Portugalia qeveriset nga tre f: fado, futboll dhe Fatima. Është gjithashtu një vend shumë katolik, gjë që



është shumë mirë për mua. Më kujton Kubën, sepse njerëzit nuk kanë shumë, por hapin derën e çdo shtëpie, shkojnë në ndonjë rrugicë dhe gjithmonë dëgjon muzikë. Gjithmonë dëgjon shumë fado dhe kuduro, një zhanër muzikor anglez. Gjithashtu edhe shumë xhaz: një gjë e bukur. Kam takuar shumë muzikantë të mrekullueshëm dhe shumë prej tyre përfunduan duke bashkëpunuar në albumin tim të ri, kështu që Lisbona ndikoi në muzikën time dhe në punën time. E si mund të ndodhte ndryshe? E pamundur të kaloja një vit pa qenë e kushtëzuar nga gjithë kultura që më rrethonte".

Por jeta e nënës së një futbollisti, zbuloi Madona, nuk është fushë me lule. "Çdo grua që u kushton kohë të plotë fëmijëve të saj, që vjen dhe shkon nga fusha e futbollit, do të përgjigjej që në jetë nuk ka pse ndryshojnë gjërat nga javë në javë dhe nga fundjavë në fundjavë: nganjëherë ata janë në qytet, ndonjëherë jo, dhe deri të enjten në mbrëmje nuk e dimë nëse do të jenë të shtunën apo të dielën. Është e pamundur të organizohesh dhe pastaj ke ndjesinë e të qenit e padrejtë ndaj fëmijëve të tjerë, për të mos e llogaritur veten!"

Por, popstarja tregon që të gjithë fëmijët e saj janë përshtatur me ndryshimin. "Gjëja më e habitshme është aftësia e tyre për të kapërcyer çdo pengesë, për t'u zhytur në çdo gjë, në muzikë, vallëzim, në futboll dhe në sport në përgjithësi, aktivitete që i sjellin ata në kontakt të ngushtë me të tjerët dhe lehtësojnë përshtatjen. Djemtë kanë mësuar të flasin portugalisht, duke qëndruar në mesin e të tjerëve, pa pasur nevojë të kenë një dërrasë të zezë para tyre, për të kuptuar njëri-tjetrin. Në këtë mënyrë të mësuarit bëhet argëtues, interaktiv. Mbi të gjitha për Stellën dhe Esterën, të cilat kaluan katër vjet në një jetimore; janë kaq të lumtura që janë me të tjerët, që ndihen të dobishme, që janë pjesë e një grupi, i vogël apo i madh qoftë. Ata janë jashtëzakonisht të forta dhe plot me energji dhe gëzim. Janë dy vajza shumë të hapura dhe për shkak të punës sime dhe udhëtimeve të vazhdueshme në mbarë botën, gjërave që bëj dhe vendeve ku shkoj. Të gjithë fëmijët e mi janë shumë të hapur dhe jam shumë krenare për këtë. Ka njerëz që më thonë: sigurisht doni që djali juaj të bëhet një futbollist i suksesshëm, më i madhi (Lourdes) një balerin, Rocco një piktor. Dhe gjithmonë them jo, ajo që dua për fëmijët e mi është që ata të bëhen njerëz të përgjegjshëm, të aftë për të dashur dhe për të ndier dhembshuri. Asgjë tjetër. Nuk më intereson çfarë rruge ndjekin, vetëm dua që ata të jenë qenie të mira njerëzore që t'i trajtojnë të gjithë të tjerët me dinjitet dhe respekt pa marrë parasysh ngjyrën e lëkurës, fenë dhe gjininë. Kjo është gjëja më e rëndësishme. Nëse ata do të bëheshin Picasso tjetër ose Cristiano Ronaldo, shumë mirë, kjo do të ishte qershia mbi tortë".



Madona gjithashtu foli për Malawi, ku në vitin 2006 ajo themeloi organizatën bamirëse Raising Malawi, e krijuar për të ndihmuar fëmijët vendas jetimë nga AIDS, dhe ku ajo takoi dhe adoptoi fëmijët e saj, David dhe Mercy James. Vitin e kaluar ajo hapi spitalin e parë pediatrik në vend, që mban emrin e vajzës së saj, Mercy James, dhe se ylli i muzikës pop do ta vizitojë së shpejti në përvjetorin e parë të përurimit. "Ideja nuk është që të sjellim njerëz nga jashtë, por të edukohen dhe të përgatiten malavitët që duan të jenë doktorë, kirurgë, infermierë: kjo është mënyra në të cilën një vend mund të bëhet i vetëmjaftueshëm dhe krenar në vetvete. Në spital janë kryer ndërhyrje kirurgjikale që nuk bëhen askund tjetër në botë. Javën e kaluar, në kujdesin intensiv, u krye një operacion te dy binjakë siamezë të lindur me mëlçi të përbashkët. Shanset që ata t'i mbijetonin operacionit, – që ata të jetonin, – ishin shumë të pakta. Në fund, jo vetëm që kirurgjia kishte sukses, por fëmijët mbijetuan dhe po shërohen. Dhe sigurisht kjo na bën krenarë dhe do të thotë shumë për njerëzit lokalë dhe komunitetin.

*(gazeta-Shqip.com)*

Autor: Gazmend Morina - BENI

AKTORI AMERIKAN NË FOTO 1 | KUNDËRSHTAR NË MENDIME, KUNDËRVËNËS | DËSHIRA E SËMURË PËR TË PËRDORUR OPIUMIN (med.) | IRNOSEMI (bised.) | VEPËR E JOSIP RELËS | SHPEND ME QAFË TË GJATË (sh.shq.) / TITAN | ZANORE | FUTBOLLISTI ANGLEZ DARIUS ..... | EPOKA E RE | LUFTËTARI KRYESOR MË DEMA NË SPANJË, I CILI E MBYT DEMIN E PLAGOSUR | BABAI



1

- EMËRORE, RASA E PARË E LAKIMIT (gram.)
- MIMOZA AHMETI / PEMË E VENDEVE TË NGROHTA (sh.shq.)
- GAZ LUFTE QË SHKAKTON PLAGË NË LËKURË DHE HELMON ORGANIZMIN (shq.)
- KRYEMURG / KRYETAR I NJË EPARKIE ORTODOKSE
- GRUAJA QË PISPILLOHET PËR SË TEPËRMI; LOZONJARE (fr.)
- PIKTORI YNË .... VALLA (shq.) / OTRANTO, BARI
- TINGULLIMIT-IMI (muz.)
- KËNGËTARJA ME FAMË BOTËRORE MORISET
- ROKERI I NJOHUR KRAVITZ (shqip.)
- RILINDËSI YNË JERONIM
- POEMA E VOGËL QË JEP NJË NGJARJE / LLOJ KARR-OCE KUAJSH
- VENDI KU LIDHEN ESHTRAT
- DANTE ALIGIERI
- BASHKËTING-ËLLORE / ACTIVE TRAINING EDUCATION
- PJESË E PORTIT DETAR
- STANDARDS TRANSPORT. ZIMBABWE
- ZOG I EGËR GRABITQAR / BASKETBOLL-ISTI YNË EDMOND
- EPOKË (shq.) / KLUB FUTBOLLI GREK
- METODË STUDIMI
- TRISKA, KUPONI
- MUZIKA E SHTHURUR
- QË KA KARAKTERIN E NJË MITI / TRAJNERI ITALIAN MARÇELO ....
- BASHKËTING-ËLLORE
- TENISTI I NJOHUR ..... SAFIN / DHËNIA E NJË ÇMIMI TË LARTË
- DY BASHKË-TINGËLLORE / MJET PËR RRËSHQITJE PËR FËMIJË ME RROTA
- AKTORJA AMERIKANE PORTMAN (shqip.) / BASHKËTING-ËLLORE
- KËNGËTARJA SHQIPTARE MARKU
- LLOJ LËNDE PLASËSE / KAMËS; I PASUR; I .....
- DY ZANORE
- KËNGËTARJA ... ZARI / BËRJE MË I RI
- ZHANËR I MUZIKËS / LINSANDO (shk.)
- PIJE E NGROHTË ORIENTALE (shq.) / DAFINË
- SHENJA NGA PREKJA E DIÇKAJE
- RESTORANT, KAFE OSE BAR-BUFE (bised.) / DEM
- FUTBOLLISTI ..... CANA / SHKRONJA XXIV
- EPOKA E RE
- "R" para dy "I" / FEMËR E ZGJEDHUR
- HISTORIANI ROMAK LUKRECI / FUTBOLLISTI HOLANDEZ RAFAEL ... DER VART
- HUMANISTI ..... BIÇIKEMI (shq.) / VIGAN, KOLOS
- EVERTON / BIMË BARISHTORE ME TË CILËN BËHET PILAFI
- METËR; INDIUM / FUTBOLLISTI BERBATOV (MAN. UTD.)
- QË KA HUMBUR NJOMËSINË, QË Ë ËSHTË FISHKUR / TEFIK OSMANI
- ISH FUTBOLLIST I NJOHUR BRAZILIAN / AKTORJA E NJOHUR BASIGNER
- SHKOMBËTA-RIZIMI
- AZOT, IRIDIUM / SHKATËRRIMI, RRËNIMI
- KALJARI, ATALANTA / HAITI
- TOKA E BUKËS / MURG I VETMUAR
- KËNGËTARI BRITANIK ..... WEBBE
- HAPËSIRË E MADHE UJI / AKTORJA AMERIKANE NË FOTO 1
- PRODUKT I ZJARRIT / KËNGËTARI FRANÇESK
- FUTBOLLISTI YNË ZABËRGJA / EMRI I KOMANDANTIT LEGJENDAR TË UÇK-së



2

- PJESËTAR I EKUIPAZHIT TË NJË ANIJEJE
- SMIRA, RESA / QYTET I LASHTË NË ILIRI
- ERMELINDA MEKSI
- SHEGË / KËNGËTARI ..... HOXHA
- DEPARTMENT EDUCATION TRAINING / LLOJ VEGLE MUZIKORE
- MOLDE
- SUPER MODELJA KATE .... (shqip.)
- MËDYSHJA / RESHAT ARBANA
- ZANORE / LLOJ PESHKU
- MARRJA E TIPAREVE TË PARAARDHË-SVE TANË
- DY BASHKË-TINGËLLORE / NJËSIA E KOHËS
- MJET SHPËRTHYES
- OTO REHAGEL / AZEM SYLA
- AKTORJA E NJOHUR SPELLING / DY BASHKË-TINGËLLORE
- AKTORJA HOLLIVUDIANE TURMAN
- RRËNJËS; KUNDREJT ARDHËS / ZANORE
- KORNIZË / RUANDA
- FSHATI NË TË CILIN GJENDET AEROPORTI I TIRANËS
- MJET I THJESHTË LUNDRIMI (shq.)

E jashtëzakonshme

## Ura e ndërtuar nga 50 mijë shkopinj të bambusë



Ura mahnitëse, e gjatë një kilometër, në Kamboxhia është e ndërtuar nga 50 mijë shkopinj të fortë të bambusë. Ajo rindërtohet çdo vit nga banorët e vendit, shkruan "Daily Mail". Ura ndërtohet në kohë të thatë për ta lidhur qytetin Kampong Cham me një mijë familje që jetojnë në ishullin Koh Paen.

FOTO E DITES



Njerëzit shihen nëpër anije duke kaluar përmes ujërave nga përmbytjet në periferi të Hanoit në Vietnam. /AFP/

E rrallë

## Dronët do t'i zëvendësojnë rojet e plazhit



Interesant, njëkohësisht edhe shumë efikas, është përdorimi i dronëve për shpëtimin e jetës së njerëzve kur ata gjenden në rrezik. Kjo është demonstruar në Australi së fundmi përmes një video se si përmes dronit mundësohet shpëtimi i dy personave nga valët e mëdha. Kjo formë testimi duket se nuk do të mbetet vetëm në Australi, pasi në nëntor të këtij viti edhe Italia do t'i prezantojë projektet e para në Sea Drone Tech Summit.

## BARSOLETA E DITËS



**Jeta**
**- A ke "Facebook"?**
**- Po.**
**- "Msn"?**
**- Po.**
**- "Skype"?**
**- Po.**
**- "Twitter"?**
**- Po.**
**- E jetë?**
**- Po kam edhe jetë, por ia kam harruar fjalëkalimin.**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Vetem gjate vikendit në ora 16:00**

### " INCREDIBLES 2" 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

**Rolet:** Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

**Regjia:** Brad Bird





**Në ora 18:20**

### "FUTURE WORLD"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

**Regjia:** James Franco

**Në ora 20:00**

### "ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

**Rolet:** Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

**Regjia:** Peyton Reed





**Në ora 22:00**

### "LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

**Rolet:** Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

**Regjia:** Fernando León de Aranoa

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Keni guxuar më shumë sesa që duhet këtë periudhë dhe sot do të jetë momenti që do t'ju duhet të merrni mbi vete të gjitha përgjegjësitë.



**DEMI**
Sot do t'ju duhet të jepni prova për altruizmin tuaj, sidomos në raportet familjare. Do të hiqni dorë nga një gjë që e keni mjaft për zemër.



**BINJAKËT**
Keni kohë që jeni bërë viktima të konformizmit. Nëse gjërat do të ndryshojnë sot do të jetë një ndryshim për mirë.



**GAFORRJA**
Është një çështje që ju shqetëson prej kohësh dhe sot ka ardhur momenti t'i jepni fund. Gjithë ky shqetësim do të duket sikur s'ka ekzistuar.



**LUANI**
Ka projekte që ju kanë zënë shumë nga koha juaj dhe që do të kuptoni që nuk mund të realizohen. Filloni mbani distancë përpara se të jetë vonë.



**VIRGJËRESHA**
Kontaktet që keni krijuar gjatë karrierës suaj do t'ju ndihmojnë të merrni një vendim që po e shtyni prej kohësh. Çdo gjë do të shkojë mirë.



**PESHORJA**
Nëse nuk doni ta humbni mbështetjen e personave pranë jush duhet të jeni më i pranishëm në jetën e tyre dhe t'i mbështesni në çdo hap.



**AKREPI**
Keni kohë që keni qëndruar në të njëjtin vend pa bërë hapa përpara. Kjo gjendje po ju bën të ndiheni keq dhe të mbylleni në vetvete.



**SHIGJETARI**
Keni zgjedhur mënyrën më të mirë për të qenë vërtet të lumtur. Jeni të mbushur me optimizëm këtë periudhë dhe kjo ju ka ndihmuar.



**BRICJAPI**
Kohët e fundit keni qenë mjaft të zënë me jetën tuaj private duke lënë pas dore impenjimet profesionale. Mund të krijojë ngecje në karrierë.



**UJORI**
Sot mund të merrni vendime shumë të ndryshme nga sa keni thënë më parë. Kjo sepse në çdo moment do të keni ndryshime të situatave.



**PESHQIT**
Është mirë të mos komentoni shumë idetë tuaja tek persona që sapo i keni njohur. Mund t'i përvetësojnë si të tyret.




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | HULL - ASTON VILLA | 3+ | DRESDEN - DUISBURG | GG | CHATEAUROUX - LORIENT | 1 |

# Shtatë skuadra të Superligës me ndryshime në shtabe teknike

Shtatë klube të elitës kanë bërë ndryshime në pozitat e trajnerit para fillimit të edicionit 2018/2019, kurse pesë klubet e tjera u kanë besuar trajnerëve që kishin. Numri i ndryshimeve të shpeshta nëpër klubet e futbollit në Kosovë është i madh dhe i natyrshëm



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 5 GUSHT - Më pak se një muaj ka mbetur deri te fillimi i Superligës së Kosovës në futboll, kurse skuadrat janë treguar mjaft aktive në afatin kalimtar, përfshirë edhe ndryshimet në shtabet teknike. Shtatë nga dymbëdhjetë skuadrat që numëron elita kanë bërë ndryshime në shtabe teknike. Skuadra më e suksesshme nga edicioni i kaluar, Drita që nën drejtimin e Bekim Isufit shkroi historinë duke u shpallur kampione e Kosovës pas plot pesëmbëdhjetë vjetësh, nuk ka bërë ndryshime dhe skuadrës sërish do t'i prijë Isufi. "Kur jam emëruar trajner i Dritës kemi bërë marrëveshje për dy vjet e gjysmë", ka deklaruar Isufi, duke konfirmuar qëndrimin në skuadrën gjilanase. Ashtu sikurse Drita, edhe Prishtina i ka besuar Mirel Josës, i cili kryeqytetasve ua rikthej trofeun e Kupës. Synim i trajnerit shqiptar në edicionin e ri është titulli i kampiones që i mungon Prishtinës që disa vjet. Dy skuadrat e tjera që nuk kanë ndryshuar trajnerë janë Trepça '89 dhe Feronikeli, që drejtohet nga trajnerët nga Shqipëria. Këto dy skuadra nuk arritën ndonjë sukses edicionin që përfundoi, por Gugash Magani dhe Sulejman Starova mbetën të paprekshëm. Skuadra e pestë dhe e fundit që nuk bëri ndryshime ishte Ballkani nga Theranda. Kjo skuadër nën drejtimin e Bekim Shotanit u rikthye në elitë dhe me strategun vushtrrias pritet ta vazhdojë rrugëtimin në rangun më të lartë të garave. Ndërsa befasia më e mëdha në ndryshimin e trajnerit ishte te skuadra e Llapit, pasi Tahir Batatina vendosi ta lirojë vendin për trajnerin e suksesshëm në Kosovë, Bylbyl Sokoli. "Profa" pati disa mosmarrëveshje me drejtuesit e Llapit, por ai do të jetë në krye të skuadrës llapjane. "Sokoli e ka kontratën njëvjeçare me skuadrën e Llapit, por dihet se trajnerin e mbajnë vetëm rezultatet dhe asgjë tjetër në bankën e një skuadre", ka thënë Tahir Batatina, drejtor i KF Llapi.
Liria e Prizrenit, pavarësisht prej problemeve, pati një sezon të mirë, por ky klub u braktis nga Blendi Shkëmbi dhe në vend të tij u emërua Bedridin Gjinali. Ndërkohë, edhe Drenica pësoi ndryshime ku Sadat Pajaziti u largua nga ky klub për ta marrë drejtimin e Gjilanit, kurse Tahir Lushtaku nga posti i drejtorit është emëruar trajner i kuqezinjve. Ferizaj që u rikthye në elitë u braktis nga Bylbyl Sokoli, por sërish kësaj skuadre do t'i prijë një trajner i madh, Afrim Tovërlani. KEK-u është skuadra tjerr e rikthyer në elitë dhe pas ndërprerjes së bashkëpunimit me trajnerin shqiptar Bledar Devolli e ka rikthyer sërish Musa Selimin. Ndryshime në shtabin teknik ka bërë edhe skuadra e Flamurtarit nga Prishtina, e cila, në vend të Gafurr Rexhepit e emëroi ish-trajnerin e 2 Korrikut, Prishtinës dhe Trepçës '89, Arsim Thaqin.

## SHKURT

### Januzi largohet nga Prishtina

Sulmuesi Ahmed Januzi nuk do të jetë pjesë e Prishtinës në edicionin e ri të futbollit, pasi i ka skaduar kontrata dhe drejtuesit e klubit nuk e kanë parë të arsyeshme rinovimin e saj. "Ahmed Januzit i ka skaduar kontrata dhe më nuk do të jetë pjesë e Prishtinës. Skuadra tani është në kërkim të një sulmuesi tjetër, por jo me patjetër", thuhet në njoftimin e Prishtinës.
Ditë më parë interesim për ish-sulmuesin e Kombëtares së Shqipërisë ka shfaqur skuadra e Dritës nga Gjilani.

### Roma interesohet për Xhakën

AS Roma ka dështuar për ta transferuar mesfushorin e Sevillës, Steven Nzonzi. Skuadra nga kryeqyteti italian tash e ka rikthyer fokusin nga mesfushori i Arsenalit, Granit Xhaka. Sipas "Roma News", drejtuesit e Romës e shohin futbollistin shqiptar si një zëvendësues për Radja Nainggolanin, i cili iu bashkua Interit.

### Shala nga Lyngby te IK Start

Mesfushori i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Herolind Shala, është larguar nga Lyngby, kurse karrierën do ta vazhdojë në skuadrën e IK Start. "Klub i ri në karrierë. Nga sot jam pjesë e skuadrës norvegjeze IK Start. Më bindi projekti i ri i klubit për të nënshkruar këtu. Shpresojmë se do t'i arrijmë objektivat", ka shkruar Shala në "Facebook", i cili ka luajtur edhe për Notodden, Odd, Sparta Prague, Slovan Liberec dhe Kasimpasa.

### Dovizioso triumfon në Çeki

Andrea Dovizioso me Ducatin ka arritur të triumfojë në garën e Çmimit të Madh të Republikës Çeke në Moto Gp. Ky është suksesi i dytë sezonal për pilotin italian, i cili e la pas shokun e tij të skuadrës Jorge Lorenzo (i dyti) dhe kampionin e botës në fuqi, Marc Marquez me Hondan (i treti). Kjo treshe dhuroi spektakël gjatë gjithë kohës në pistën e Brnos, duke dueluar për fitore deri në metrin e fundit, ndërkohë që i katërti u klasifikua Valentino Rossi me Yamaha, që me "fotofinish" fitoi duelin me Cal Crutchlow, i pesti. Për Dovizioso ky është triumfi i dytë sezonal pas atij në garën hapëse, sukses që erdhi në garën e tij numër 100 me motorin Ducati, fitorja e 10 në karrierën e tij në Moto GP.

## Mula: Në Rusi arrita të shkoj vetëm me pasaportë shqiptare



PRISHTINË, 5 GUSHT - Alpinistja Arineta Mula ka postuar edhe një fotografi me flamurin e shtetit shqiptar në majën Elbrus në Rusi, duke iu falënderuar Shqipërisë për dhënien e pasaportës shqiptare. Ajo ka treguar se në Rusi ka arritur të udhëtojë vetëm me atë pasaportë. "Pa pasaportë shqiptare nuk do të mund të udhëtoja në Rusi për ngjitje në majën më të lartë në Evropë, Elbrus. Edhe pse kisha mundësi të tjera për udhëtim, insistova të pres dhe të udhëtoj me pasaportë shqiptare", ka treguar Mula. Ajo ka thënë se ngjitja të cilën e ka bërë pa udhëheqës dhe në kushte të vështira klimatike e ka realizuar bashkë me dy flamujt, atë të Kosovës dhe të Shqipërisë. "Faleminderit presidentit të Shqipërisë, Ilir Meta. Po ashtu, faleminderit ambasadorit të Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi. Gjithmonë miq Kosove e Shqipërie", ka shkruar ajo.

## Pensionohet Debatik Curri

Prishtinë, 5 gusht - Ish-lojtari i Kombëtares së Shqipërisë, Debatik Curri, është pensionuar nga futbolli aktiv. Faqja zyrtare e skuadrës së Prishtinës e ka konfirmuar lajmin për pensionimin e mbrojtësit "bardhekaltër", i cili tash e tutje do të punojë në stafin e trajnerëve. "Debatik Curri nga ky edicion do të punojë me skuadrën, por do të jetë në stafin e trajnerit duke i dhënë ngadalë fund karrierës brilante që ka pasur vetes", thuhet në njoftimin e Prishtinës. Curri gjatë karrierës së tij ka luajtur për Prishtinën, Vorskla Poltavën, Gençlerbirligin, Hoverla Uzhhorodin, Sevastopolin, Tiranën dhe Flamurtari Vlorë.



# Maldini rikthehet te Milani

MILANO, 5 GUSHT - "Epoka e re" e AC Milan është përforcuar më tej me emërimin e Paolo Maldini si drejtor i zhvillimit të strategjisë në fushën sportive. "Paolo është një 'legjendë' e mirëfilltë për historinë kuqezi, për klasën e tij të jashtëzakonshme, për talentin, aftësitë udhëheqëse, besnikërinë dhe rekordin e sukseseve, që nuk mund të krahasohet me askënd. Këto cilësi do të luajnë një rol thelbësor për ta kthyer Milan te madhështia që i takon", kjo ishte një pjesë e komunikatës së klubit kuqezi ku zyrtarizonte rikthimin e Paolo Maldini në Milanello. Konferenca e shtypit ku do të prezantohet ish-kapiteni do të mbahet nesër pasdite në "Casa Milan". Maldini, numri tri më i famshëm në historinë e Milanit dhe gjithë Serinë A, debutoi me ekipin e parë kur ishte 16 vjeç. Gjatë karrierës së tij, me 648 ndeshje në Serinë A, 419 prej të cilave si kapiten, ai ka fituar 26 trofe: 7 tituj në Itali, 5 trofe të Ligës së Kampionëve, 5 Superkupa të Italisë, 1 Kupë të Italisë, 5 Superkupa të Europës, 1 Botëror për klube dhe 2 Kupa Interkontinentale. Ndeshjen e fundit me Milanin ai e luajti në vitin 2009.



# Jordani, aleancë me LeBronin, del kundër presidentit Trump




LOS ANGELES, 5 GUSHT - Presidenti i Amerikës, Donald Trump, shpresonte se legjenda e NBA-së, Michael Jordan, do ta mbështeste në "luftën" që i ka shpallur yllit të ri të Lakersit, LeBron James. Por kreu i Shtëpisë së Bardhë ka marrë një tjetër "shuplakë", këtë herë nga Jordani, që përmes zëdhënësit të tij për shtyp ka bërë me dije se mbështet "King James" në deklaratat e tij. "Mbështes LeBron. Po bën një punë të jashtëzakonshme për ta mbështetur komunitetin tonë dhe kjo është për t'u vlerësuar", u shpreh zëdhënësi i Michael Jordan, duke konfirmuar se gjashtë herë kampioni i NBA-së është në krah të yllit të Lakersit. Trumpi e cilësoi James një idiot dhe shtoi se preferonte Jordanin para LeBronin, por duket se, pavarësisht prej lajkave që i ka bërë ikonës së NBA-së, nuk ka mundur ta bëjë atë për vete. Akuzat për racizëm që shumica e sportit amerikan ka ngritur kundër kreut të Shtëpisë së Bardhë kanë bërë që Trumpi të mos ketë respektin e yjeve të sportit dhe ata kanë dalë kundër presidentit të Amerikës.

## SHKURT

### Lëndohet Sadiku

Reprezentuesi i Shqipërisë, Armando Sadiku, ka pësuar një lëndim në ndeshjen miqësore që Leveante e zhvilloi ndaj Heerenveenit. Sulmuesi Kuqezi u aktivizua në pjesën e dytë, kurse në minutën e 70 është dashur ta lëshojë terrenin për shkak të lëndimit. "Dyshohet se Armando Sadiku ka një dëmtim të rëndë në gjurin e majtë. Shkalla e tij do të përcaktohet më saktë pas testeve të detajuara mjekësore", thuhet në njoftimin e skuadrës spanjolle.

### Morata përfundimisht nuk largohet nga Chelsea

Alvaro Morata përfundimisht ka vendosur për të qëndruar në skuadrën e Chelseat. Ai ka thënë se ka mundur të transferohet në Itali dhe Spanjë, por vendosi t'i mbetet besnik skuadrës angleze. "Mund të shkoja diku ku mund të fitoja më shumë të ardhura, por në fund vendosa të qëndroj te Chelsea", ka thënë Morata.

### Allegri: Afati kalimtar është mbyllur për Juventusin

Trajneri i Juventusit, Massimiliano Allegri, ka konfirmuar se nuk do të ketë transferime të reja në Juventus këtë verë. Këtë afat kalimtar Juventusi ka transferuar Cristiano Ronaldon, Leonardo Bonuccin dhe Joao Cancelon. Këto transferime e kanë kompletuar skuadrën e "Zonjës së Vjetër" dhe Allegri nuk dëshiron lojtarë të rinj në skuadër. "Klubi tanimë e ka bërë atë që e ka pasur detyrë. Blerje të tjera? Jemi mjaftueshëm pretendentë kështu si jemi dhe unë mezi po pres të fillojë sezoni dhe t'i kem të gjithë lojtarët së bashku", ka thënë Allegri. "Do të jetë një sezon mjaft i vështirë, kështu që ne kemi nevojë për të gjithë. Disa lojtarë të rinj kanë shfaqur shumë talent në ShBA, kështu që edhe ata mund të gjejnë vend në ekip të parë", ka deklaruar Allegri.

### Nëse Modriqi largohet, Reali transferon Eriksenin

Real Madridi ka kthyer vëmendjen kah mesfushori i Tottenhamit, Christian Eriksen, në rast të largimit të Luka Modriqit. Sipas "Don Balon", madrilenët janë të gatshëm të shpenzojnë deri 200 milionë euro për danezin, por vetëm nëse Modriq ikën nga "Mbretërit". Modriqi po kërkohet nga Interi dhe Reali tashmë ka bërë gati listën e zëvendësuesve nëse mbetet pa yllin kroat.

### Kroosi, lojtari më i mirë gjerman

Tashmë është shpallur edhe lojtari më i mirë gjerman për këtë vit. Ka qenë "Kicker Magazine" ajo që ka shpallur lojtarin e Realit të Madridit, Toni Kroos, si më të mirin e gjermanëve. Kroosi arriti ta fitonte Ligën e Kampionëve me skuadrën e Realit dhe ka arritur të bëjë një paraqitje të mirë në Botëror, ndryshe nga pjesa e ekipit që e shoqëronte. Lojtari ka treguar se di të qëndrojë konstant dhe nuk ka pasur luhatje në lojën e tij. Ndoshta vetëm ai mund ta meritonte këtë çmim nga gjermanët.

### Kameruni emëron trajnerë legjendat e Holandës

Ministri i Sporteve në Kamerun ka zyrtarizuar trajnerët e rinj të skuadrës përfaqësuese që do të jenë një dyshe e famshme holandeze. Bëhet fjalë për Clarence Seedorf, që do ta marrë postin e trajnerit të parë dhe Patrick Kluivert, që do të jetë ndihmësi i tij në këtë përvojë. Të dy këta kanë qenë pjesë e Holandës në periudhën 1994-2004, ndërsa Seedorf ka përvojë si trajner te Milani dhe klubi kinez i Shenzhenit. Ministri kamerunas theksoi se Seedorf do të ketë më pak se një vit kohë për të punuar në kuadër të Kupës së Afrikës, që do të zhvillohet pikërisht në Kamerun, në qershor të 2019-s.




RESTAURANT
SWISS
TAVERNA
Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
Prishtinë

Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM

Nr.13/514
Më: 04.08.2018
D r a g a s h

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit mbi Punën në Republikën e Kosovës, nr.03/L-212, nenit 5 të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.10/2018 të datës 20.07.2018 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ nr.05/2015- normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, vendimin e MASHT nr.232/01B, vendimin e MASHT nr.231/01B të datës, 04 Gusht 2015, kërkesën nga MASHT ref.2-2955 të datës 01 Korrik 2016. Drejtoria Komunale për Arsim në Dragash, shpall:

NJOFTIM PËR PËR PËRMIRËSIM TË KONKURSIT

Në konkursin e shpallur me datë 03.08.2018, me nr. protokoli 13/511 dhe publikuar në gazetën "Epoka e Re" me datën 04.08.2018, për pozitën Dy mësimdhënës për Gjuhë Boshnjake në SHFMU " Fetah Sylejmani ", është lëshuar një gabim teknik, ashtu që në vend të "Dy mësimdhënës për gjuhë Boshnjake" ***kërkohen***: **Dy mësimdhënës për mësim klasor në gjuhën Boshnjake** në SHFMU "Fetah Sylejmani".

Na osnovu Zakona o Preduniverzitetskom Obrazovanju Republike Kosova br. 04/L-032, člana 8 Zakona o Radu Republike Kosova br. 03/L-212, člana 5 Zakona br.03/L-068, Administrativnog Uputstva br.10/2018, od dana 20.07.2018 normativi o strucnom kadru u opstem obrazovanju, Administrativnog Uputstva br.05/2015, normativi o nastavnicima profesionalnog obrazovanja, Administrativnog Uputstva br.07/2017 o regulisanju procedura konkurisanja u Javnom sektoru, Odluke MONT-a br.232/01B, Odluke MONT-a br.231/01B od dana 04.08.2015, zahteva MONT-a ref.2-2955 od dana 01.07.2016, Direktorijat za Obrazovanje u Dragašu objavljuje:

Obavještenje u vezi ispravljanje greške Konkursa

Na konkursu koji je objavljen 03.08.2018, sa protokolarnim brojom 13/511, a objavljen u novinama "Epoka e Re" dana 04.08.2018, za poziciju Dva nastavnika za Bosanski jezik u OiSŠ "Fetah Sylejmani", je napravljena jedna tehnička greška, tako da umesto "Dva nastavnika za Bosanski jezik" traži se: Dva nastavnika razredne nastave na Bosanskom jeziku u OiSŠ "Fetah Sylejmani".

Datë:04.08.2018
Dragash

Drejtori i DKA-së
MSc. Vloran Cenaj




## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera për një familje me dy dhoma gjumi. Banesa duhet të jetë e mobiluar bukur dhe është për afat të gjatë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049/472-770.

▶ Urgjentisht kërkoj banesë për blerje në Fushë Kosovë. Çmimi 25.000-30.000 €uro Tel 044/741-155.

▶ Lëshoj banesa me qira afër Eulex-it, ish Farmedi, në lagje të spitalit, banesa është e lirë që nga data 01.08.2018. Banesat janë të ndërtuar nga kompania "Cima Contrekshen" njëra banesë ka 112 metër katror ndërsa tjetra 85 metër katror. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 044-923-527 dhe 044-402-679.

▶ Urgjentisht kërkoj një banës me qera për një person te huaj, Banesa duhet te jete jo shumë larg qendrës, mundësisht tek "Qafa" ose "Tophane" Duhet te ketë dy dhoma gjumi, te jete e mobiluar bukur. Çmimi deri 300 euro. Për info: Tel 049-472-770

▶ Lëshoj me qira banesën në Prishtinë, Lagja Mati 1, rr. Ndue Perlleshi (pas 13 katshes). Banesa ka 58 m. katrorë, e mobiluar. Nr. kontaktues 044-121-668 ose 044-172-938. Çmimi sipas marrëveshjes.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehje qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

▶ Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

▶ Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shiheni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.

▶ Shesim banesën dy dhomëshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit , çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387

▶ Lëshoj banesën e pamobiluar (garsonierë) me qira. Banesa, e cila gjendet rrugës për në Gërmi, 150 metra afër Kolegjit Amerikan A.U.K, ndodhet në katin 5. Çmimi 130 euro. Tel: 049/705-503 dhe 049/662-211.

▶ Lëshoj garsonierën me qira 13 m2 kati i IV (katër) në Lagjen Ulpiana. Çmimi 150 euro. Për info: 044/637-546.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Ulpiana objekti C7 kati i 3 hyrja e II-të nr 11 ka 50 m2 dy dhomshe , një banjo, kuzhinë të gjitha të reja, është e përshtatshme për zyre edhe apo ordinancë. Për informata nr tel; 044/641-524 dhe + 46705793508.


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L


AUTOSHKOLLA
"RITMO – L"
Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë
Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.
Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333